



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

WWW.UMED.EDU.AL



# **RAPORTI VJETOR**

**I VEPRIMTARISË MËSIMORE,  
KËRKIMORE-SHKENCORE, DHE  
FINANCIARE  
VITI AKADEMIK 2021-2022**

*Tiranë, Janar 2023*



# Përmbajtja

I. HYRJE .....	4
II. PËRMBLEDHJE .....	5
III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UMT .....	9
3.1 Organizimi i UMT-së .....	9
3.2 Funkcioni i organeve kolegjiale/drejtuese.....	10
3.3 Njësitë administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad- hoc .....	12
3.4 Aktiviteti i njësive kryesore .....	13
3.4.1 Fakulteti i Mjekësisë .....	13
3.4.2 Fakulteti i Mjekësisë Dentare.....	16
3.4.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike .....	18
3.5 Sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore .....	19
IV. VEPRIMTARIA AKADEMIKE.....	21
4.1 Programet e studimit .....	21
4.2 Procesi mësimor, mësimdhënia, vlerësimi dhe pranimet.....	22
V. SIGURIMI I CILËSISË.....	26
VI. PERSONELI AKADEMIK .....	27
5.1 Personeli akademik.....	27
VII. KËRKIMI SHKENCOR.....	30
6.0 Kërkimi shkencor dhe Titujt akademik .....	30
6.1 Fakulteti i Mjekësisë .....	30
6.3 Fakulteti i Mjekësisë Dentare.....	32
6.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.....	37
6.4 Bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel universiteti.....	38
Projekte (përmbledhje e projekteve të tri njësive kryesore dhe rektoratit) .....	39
6.5 Shkëmbimet në kuadër të Programit Erasmus+ .....	41
6.6 Anëtarësimi i UMT-së në rrjete ndërkombëtare.....	43
6.7 Aktivitete të edukimit të vazhdim, të akredituara nga Qendra e Zhvillimit Profesional në UMT.....	43
VIII. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA NË FUNKSION TË AKTIVITETIT AKADEMIK.....	45
7.1 Infrastruktura, logjistika dhe shërbimet .....	45
IX. STUDENTËT.....	48
8.1 Regjistrimet në programet e studimit për vitin akademik 2021-2022 .....	48
8.2 Mbështetja ndaj studentëve .....	50
8.2 Performanca e alumni-t .....	52
X. ANALIZA FINANCIARE 2022 .....	53
XI. REFERENCA .....	73

# I. HYRJE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Planin e zhvillimit strategjik të UMT- së, si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 24, datë 21.10.2019, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore për vitin akademik 2021-2022 dhe financiar për vitin (kalendarik) 2021 në nivel universiteti, në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij.

Misioni i Universiteti të Mjekësisë, Tiranë është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera në fushën e shkencave mjekësore. UMT ofron programe në tri ciklet e studimit, në përputhje me standardet me të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e shëndetësisë, me qëllim që të ofrojnë dhe praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, të synojnë në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha.

Në zbatim të misionit të universitetit dhe kuadrit ligjor në fuqi, ky raport synon të paraqesë aspektet kryesore të aktivitetit akademik në UMT, duke vënë theksin edhe te problematika të evidentuara dhe të adresuara për zgjidhje, me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë.

Ky raport bazohet më raportet analitike të njësive kryesore (fakultetet) të UMT-së, si dhe të strukturave të tjera të UMT-së, Konkretisht, ky raport është bazuar në:

Raportin Vjetor të Fakultetit të Mjekësisë përcjellë me shkresë nr. 2563/1 prot., datë 19.12.2022 “*Raporti vjetor mësimor, kërkimor-shkencor e financiar*”;

Raportin Vjetor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare përcjellë me shkresë nr. 708/4 prot., datë 12.01.2023 “*Raporti vjetor mësimor, kërkimor-shkencor e financiar*”;

Raportin Vjetor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike përcjellë me shkresë nr. 1815/6 prot., datë 27.12.2022 “*Raporti vjetor mësimor, kërkimor-shkencor e financiar*”;

Raporte informuese e analitike të organeve kolegiale të UMT-së;

Raporte informuese e analitike të komisioneve në nivel universiteti (Këshilli i Botimeve, Këshilli i Etikës, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë );

Raporte informuese analitike të njësive përbërëse të Rektoratit të UMT-së, lidhur me aspektet ligjore, kurrikulën, pranime dhe sigurimin e cilësisë, projektet dhe programet e kërkimit shkencore etj.

Të dhënat statistikore të marra nga raporte vjetore të fakulteteve që paraqesin regjistrimet në programet e studimit, rezultatet e studentëve dhe kalueshmërinë, transferimet, diplomimet etj.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivitetin në tërësi të universitetit, i cili publikohet pas miratimit në organet kolegiale, ndërsa aktivitetet e detajuara në nivel njësie kryesore gjenden në raportet vjetore përkatëse të cilat janë publikuar në faqet zyrtare të fakulteteve.

## II. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor është një pasqyrë e aktivitetit akademik (2021-2022) dhe aktivitetit financiar (2022) të zhvilluar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Raporti vjetor paraqet informacione, gjetje, konstatime dhe vlerësime për të gjitha aspektet e veprimtarisë që universiteti dhe fakultetet e tij zhvillojnë.

Raporti pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje për:

- funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjiale, komisione të përhershme) në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe financiare të UMT-së dhe të fakulteteve;
- procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, njohuritë dhe kompetencat në nivel njësie kryesore;
- kërkimin shkencor, projektet dhe programet kombëtare dhe ndërkombëtare të UMT, ku personeli akademik, studentët e UMT, si dhe personeli joakademik (në programe shkëmbimi) marrin pjesë si palë aktive. Raporti adreson aspekte të politikave të kërkimit shkencor, të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga departamentet, si dhe të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor;
- programet e studimit që ofron UMT-ja, duke paraqitur programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, riorganizimin e tyre në kuadër të përditësimit, hapjen e programeve të reja si dhe ofrimin e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetit;
- angazhimin e personelit akademik dhe ngarkesën mësimore;
- gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet gjatë vitit akademik 2021-2022;
- numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UMT-ja, mbështetjen për studentët (bursa apo përjashtim/reduktimi i tarifave të shkollimit), pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi kombëtare, ndërkombëtar si dhe mbështetjen për mobilitetin e tyre në kuadër të projekteve Erasmus, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;
- mobilitetin e personelit akademik të financuar nga fakulteti/UMT-ja apo të realizuar në kuadër të projekteve/programeve;
- infrastrukturën, ku përfshihen mjediset didaktike dhe kërkimore, politike në shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numrin e teksteve dhe infrastrukturën informatike në funksion të mësimin, përmirësimit dhe plotësimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë.
- plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë kryesore të UMT-së, nga sektorët përkatës të Rektoratit, nga sekretariatet teknike të organeve kolegjiale, si dhe në bazë të raporteve dhe analizave të kryera nga UMT për institucione të tjera, rezulton se:

**Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**, organizohet dhe menaxhohet në zbatim të Statutit dhe Rregullores së tij. Organet kolegjiale dhe drejtuese të UMT-së funksionojnë bazuar në rregullore specifike e procedura, të miratuara sipas ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të UMT -së, si dhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit.

Nga burimet në dispozicion të UMT, konstatohet se është treguar përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse nga strukturat përgjegjëse. Universiteti është në gjendje të tërheqë një gamë të gjerë burimesh dhe mbështetje nga sektori i shëndetësisë dhe të përfitojë, në veçanti, nga afërsia fizike me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe strukturat e tjera spitalore universitare. Kjo ofron një shtrirje burimesh të vazhdueshme dhe të pasura, si për stafin, ashtu edhe për studentët.

Mekanizmat financiare të UMT-së për të siguruar të ardhura nga shërbime cilësore për të tretë që mund të ofrojë universiteti, me kapacitetet akademike, profesionale dhe infrastrukturore që ka (edukimi në vazhdim, ofrim shërbimi ndaj pacientëve etj.), ende nuk janë të institucionalizuara.

**Kurrikula** që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është e lidhur ngushtësisht me kërkesat e profesionit dhe mbështetet nga një rrjet i fuqishëm profesionistësh të shëndetësisë dhe urdhrash profesionalë. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara, kjo në përmbushje të misionit që UMT ka “...ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera në fushën e shkencave mjekësore. UMT ofron programe në tre ciklet e studimit, në përputhje me standardet me të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e shëndetësisë, me qëllim që të ofrojnë dhe praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, të synojnë në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha”.

Planet mësimore janë objekt rishikimi periodik nga njësitë kryesore/bazë të UMT-së. Për vitin akademik 2021-2022 janë rishikuar dhe përmirësuar disa prej planeve mësimore në të tri njësitë kryesore, përkatësisht në programet e ciklit të dytë në FM dhe në programet e ciklit të parë Bachelor të ofruara nga FMD dhe FSHMT, përmirësime të cilat nuk e kanë tejkaluar masën 20%.

Për vitin akademik 2021-2022 janë rishikuar/përmirësuar dhe konfirmuar në total 29 plane mësimore të programeve të ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”.

Gjithashtu, UMT ka finalizuar me sukses procedurat për:

- Hapjen/riorganizimin e 14 (katërmëdhjetë) programeve të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
- Hapjen e programit të ciklit të tretë Specializim Afatgjatë në “Ortodonci”, ofruar nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT.

Në kuadër të strategjisë së zhvillimit institucional, atë të ndërkombëtarizimit të UMT-së, institucioni ynë ka arritur:

- Hapjen e 2 programeve të reja të përbashkëta me Universitetin e Chieti-Pescara, përkatësisht:
  1. “Master Profesional/Master ndërkombëtar i nivelit të parë në *“Higjienë Dentare dhe Terapi Paradontale jo Kirurgjikale”*”.
  2. Master Ekzekutiv/Master ndërkombëtar i nivelit të dytë në *“Implanto Protetikë”*”.
- Hapjen e 3 doktoratave të përbashkëta me Universitetin e Bolonjës, Itali përkatësisht: Doktoratë në “Mjekësi Interne”; Doktoratë në “Kirurgji e Përgjithshme dhe nënspecialitete”; Doktoratë në “Obstetrikë-Gjinekologji”

**Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi** në UMT, kryhet në përputhje me Statutin, Rregulloren e universitetit dhe rregulloret e njëjse kryesore të tij. Në vitin akademik 2021-2022 (pas problematikave që shkaktoi pandemia e COVID-19), procesi mësimor në UMT iu rikthye normalitetit duke u zhvilluar në përputhje me planet mësimore dhe syllabuset e lëndëve si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Sigurimi i Cilësisë** në UMT është një proces i vazhdueshëm në kuadër të përmirësimit të kurrikulave, metodave të mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit, promovimit dhe kualifikimit të mëtijshëm të personelit akademik, administrativ dhe mbështetës.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, UMT i është nënshtruar procesit të akreditimit periodik institucional, i cili nisi në muajin Mars 2022 me ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm. Falë bashkëpunimit dhe kontributit të rëndësishëm të gjitha strukturave të UMT, GVB realizoi Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, pjesë e Dosjes së Akreditimit sipas kërkesave të ASCAL. Ky proces vijoi me vizitën në institucion të ekspertëve të jashtëm të përzgjedhur nga ASCAL në datat 23-24 Qershor 2022. Në përfundim, UMT u njoh me Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, në të cilin u konstatua se institucioni ka përmbushur plotësisht (vlerësimi maksimal, sipas shkallës së vlerësimit) Standardet Shtetërore të Cilësisë për vlerësimin institucional.

**Studentët** janë të organizuar në këshilla studentorë. Këto këshilla funksionojnë në bazë të akteve rregullative të miratuara prej tyre. Ata planifikojnë aktivitete në fushën e mjekësisë (ditët botërore të shëndetit) apo kulturore sociale sipas një plani vjetor. Veprimtaria e Këshillave Studentorë mbështetet nga njësitë kryesore dhe universitetit me logjistikë infrastrukurore apo materiale.

Në njësitë kryesore të UMT-së funksionojnë Zyrat e Karrierës në mbështetje të studentëve në lidhje me tregun e punës, duke siguruar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial; në zhvillimin e aktiviteteve të përvitshme për të afruar studentët në prag të diplomimit me punëdhënësit e mundshëm (panaire pune etj); në ofrimin e këshillimit dhe udhëzimeve në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve. Zyra e karrierës (ZK) bashkëpunon ngushtë me departamentet për mundësitë e akomodimit të studentëve në institucione/kompani/organizata në funksion të praktikave profesionale të studentëve; informon studentët e ardhshëm nëpërmjet aktiviteteve periodike që organizon fakulteti/universiteti për këtë qëllim. ZK mbështet, inkurajon dhe asiston jetën kulturore, artistike dhe sportive të studentëve.

Në kuadër të vlerësimit të performancës së alumni-t, UMT mbledh dhe analizon të dhënat zyrtare për punësimin e tyre, nga Urdhrat përkatës për profesionet e rregulluara, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe nga zyrat e karrierës në nivel Fakulteti.

Promovimi i studentëve të Rrjetit i Ekselencës së Studentëve të UMT-së (NES-UMeD), është një nga mbështetjet që UMT-ja jep për studentët<sup>1</sup>.

Raporti i detajuar sipas aspekteve të ndryshme akademike që trajtohen, është përshtatur dhe përmbledhur nga Drejtorja e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera pranë Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, ndërkohë që përmbledhja dhe përshtatja e analizës financiare (kreu X) është përgatitur nga Drejtorja Ekonomike pranë Rektoratit të UMT-së.

---

<sup>1</sup>Bazuar në informacionin e përcjellë nga Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Rektorati i UMT

# III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UMT

## 3.1 Organizimi i UMT-së

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 23.01.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)”, i ndryshuar. Pas riorganizimit në vitin 2016, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, aktualisht përbëhet nga 3 (tri) njësi kryesore (fakultete) si më poshtë:

- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Fakulteti i Mjekësisë, i krijuar në vitin 1957 është vazhdim i Institutit të Lartë Mjekësor (hapur për herë të parë si institucion i arsimit të lartë në Shqipëri në shtator të vitit 1952), i cili kishte për mision përgatitjen e mjekëve të përgjithshëm. Fakulteti i Mjekësisë në 2013 u riorganizua në 4 (katër) fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Farmacisë, Fakulteti i Shëndetit Publik dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Aktualisht, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është i organizuar në tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Mjekësisë
2. Fakulteti i Mjekësisë Dentare
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Ky vit përkon dhe me 70 vjetorin e hapjes së Institutit të Lartë Mjekësor, pararendësit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Në këtë kuadër, me datë 05.12.2022 u organizua ceremonia festive “70 vjet Arsim i Lartë Mjekësor në Shqipëri”.

Në ceremoni morën pjesë Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi RAMA, Ministri i Arsimit dhe Sportit Znj. Evis KUSHI dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Znj. Ogerta MANASTIRLIU. Gjithashtu, të pranishëm ishin autoritetet drejtuese të UMT, Pedagogët e dalë në pension si dhe pedagogë të cilët vazhdojnë të japin kontributin e tyre në departamentet e UMT.

Në kurorëzim të këtij 70 Vjetori, Kryeministri i Shqipërisë Z. Edi RAMA i akordon Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, **Medaljen “Ylli i Mirënjohjes Publike”** me motivacionin: “Në këtë prag 70-vjetori, për përkushtimin e treguar në formimin profesional të brezave, edukimin e tyre me vlerat njerëzore, bazë të Betimit të Hipokratit, si dhe për kontributin e veçantë, gatishmërinë e treguar në çdo kohë, por veçanërisht, si pandemia e COVID-19”.

Të pranishëm ishin figura të shquara dhe personalitete nderkomberate në fushën e mjekësisë dhe më gjerë, 2 prej të cilëve iu akordua Titulli “*Doctor Honoris Causa*”. Në këtë ceremoni iu akordua Certifikata Mirënjohje me motivacion “Për kontributin e çmuar, përkushtimin dhe profesionalizmin në formimin e brezave të tërë të punonjësve të shëndetit, si dhe përkujdesjen në nivel të lartë profesional të shumë pacientëve” figurave të mjekësisë shqiptare, të cilët kanë kontribuar me devotshmëri, përkushtim e profesionalizim.

Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT-së, struktura akademike dhe administrative e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është e organizuar si më poshtë:

- organe kolegjiale në nivel universiteti: *Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisioni i Përhershëm i Promovimit Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Botimeve, Komisioni Institucional Zgjedhor, NJSBC;*
- autoritetet drejtuese: *Rektori, Dekanët e njësive kryesore, Përgjegjësit e njësive bazë, Administratori dhe Administratorët e njësive kryesore;*
- organet drejtuese: *Rektorati, Dekanatet, Departamentet;*
- njësitë kryesore: *Fakulteti i Mjekësisë, me 16 njësi bazë; Fakulteti i Mjekësisë Dentare, me 3 njësi bazë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, me 3 njësi bazë;*
- personeli akademik dhe personel ndihmës akademik.
- struktura ndihmës akademike me karakter administrativ dhe struktura administrative në Rektoratin e UMT-së dhe e fakulteteve të UMT-së.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, e ushtron veprimtarinë e tij, kryesisht bazuar në:

- legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor (ligji nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”), Vendimet e Këshillit të Ministrave, Urdhra dhe Udhëzime të ministrit përgjegjës për arsimin, Kodin e Cilësisë për Arsimin e Lartë, si dhe akte të tjera të miratuara e që zbatohen në arsimin e lartë);
- Statutin e UMT-së (*miratuar me Urdhër nr. 424, datë 8.8.2019 të ministrit përgjegjës për arsimin*),
- Rregulloren e UMT-së;
- Vendime të organeve kolegjiale në UMT;
- Udhëzime dhe Urdhra të autoriteteve drejtuese.

### *3.2 Funkionimi i organeve kolegjiale/drejtuese*

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, të Statutit dhe të Rregullosës të UMT, çdo njësi/strukturë, personel akademik, ndihmës akademik dhe jo akademik është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procedurave, aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillon universiteti për realizimin e objektivave për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor, si dhe aktiviteteve të tjera.

Në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë janë të ngritura Komisioni i Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik (KPPPA), për dhënien e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” dhe Komisionet e Përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të UMT-së.

Referuar aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit akademik, organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese kanë kryer veprimtaritë kryesore si vijon:

**Senati Akademik** ka ushtruar kompetencat e tij në mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë

të gjithë vitit akademik, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse (107<sup>2</sup> VSA të cilat i janë adresuar njësisë përkatëse për zbatim.

Senati Akademik ka shqyrtuar dhe miratuar, me vendimet përkatëse:

- Kriteret e pranimit për programet e ciklit të parë dhe të integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2023-2024, ku për herë të parë për pranimin në programin e integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mjekësi e Përgjithshme”, do të aplikohet testimi i informatizuar me peshë 30%.
- Kuotat e pranimit në programet e studimit që ofrojnë njësitë kryesore të UMT-së për vitin akademik përkatës, si dhe propozimin për tarifatat e shkollimit për çdo program studimi.
- projekt propozimet për programet e studimit (ndryshime/përmirësime të programeve ekzistuese) propozuar nga njësitë kryesore, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së ofertës akademike të UMT;
- hapjen e programeve të reja të përbashkëta për ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve, përkatësisht me Universitetin e Chieti-Pescara dhe Universitetin e Bolonjës, Itali;
- Hapjen/riorganizimin e programeve të ciklit të tretë Doktoratë në UMT;
- Hapjen e programit të ciklit të tretë Specializim Afatgjatë në “Ortodonci”, pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare, UMT;
- marrëveshjet e bashkëpunimit me të tretë (18 marrëveshje me IAL vendase dhe të huaja gjatë vitit akademik 2021-2022);
- propozimet për dhënien e titullit akademik Prof/Prof.as
- shqyrtuar plan buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të UMT etj.

**Bordi i Administrimit** ka ushtruar kompetencat e veta në mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të UMT-së, nëpërmjet vendimeve të marra (67 vendime). Gjithashtu, Bordi i Administrimit të UMT-së gjatë vitit 2022 ka shqyrtuar dhe miratuar tarifatat për të gjitha ciklet e studimit, listat për përjashtim nga tarifa për studentët që plotësonin kriteret sipas akteve ligjore e nënligjore përkatëse, buxhetin e institucionit, për vitin 2021-2022, etj.

Bordi i Administrimit e kryen veprimtarinë e tij në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**Rektori/Dekani/Drejtuesi i departamentit** (autoritete drejtuese) kanë qenë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit mësimor, monitorimin e regjistrimit të studentëve, menaxhimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, raportimet periodike, si dhe për zgjidhjen e çështjeve të evidentuara gjatë zhvillimit të procesit mësimor, sezoneve të provimeve, praktikave profesionale dhe diplomimit. Si autoritete drejtuese, ato kanë zhvilluar takime me titullarë të institucioneve qendrore shtetërore për zgjidhjen e problematikave të hasura në institucion, si dhe kanë përcjellë projekt-propozime konkrete për të gjitha draft-aktet rregullative e nxjerra nga

---

<sup>2</sup> 107 Vendime Senati janë marrë gjatë vitit kalendarik 2022

ministrata përgjegjëse për arsimin, në kuadër të mirëfunksionimit të institucionit tonë.

Gjithashtu janë realizuar një sërë takimesh në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me të tretë, takime lobimi për universitetin, si dhe takime informuese me studentët, stafin akademik, median apo të interesuar të tjerë, në kuadër të rritjes së transparencës dhe informimit (disa prej aktiviteteve janë paraqitur edhe në faqen zyrtare të internetit të UMT-së dhe në ato të fakulteteve).

**Rektorati/dekanatet** (organe kolegjiale), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë shqyrtuar dhe marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e pranimeve/regjistrimeve të reja, transferimin e studimeve, komisionet për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Po ashtu, janë propozuar dhe miratuar grupe pune të proceseve të organizuara në nivel universiteti, në komisione apo grupe të posaçme.

**Këshilli i Botimeve** (organ kolegjial), në ushtrim të kompetencave të tij, këtë vit akademik ka shqyrtuar kërkesat lidhur me miratimin si botime shkencore apo tekste mësimore (6 tekste në total), në përputhje me standardet, për botimet akademike në UMT, në fushën e mësimdhënies dhe aktivitetit shkencor. Gjithashtu, me Vendim nr. 3, datë 07.04.2022, Këshilli i Botimeve ka miratuar “*Rregulloren mbi botimet mësimore-shkencore në UMT*”, e cila më pas ka marrë miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UMT-së. Ka vijuar publikimi online i revistës Albanian Journal of Medical and Health Sciences (nr. vol 60).

**Këshilli i Etikës** (organ kolegjial), në ushtrim të kompetencave të tij, nuk janë raportuar raste të adresuara këtij organi lidhur me mosrespektimin të kërkesave të moralit dhe të etikës në realizim të funksionit të detyrave të individëve. Përsa i përket çështjeve që lidhen me etikën në veprimtarinë studimore- kërkimore, KE ka shqyrtuar dhe miratuar 18 kërkesa për aplikim projektsh studime kërkimore.

**Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë** (organ kolegjial), në ushtrim të kompetencave të saj, ka angazhuar anëtarët e saj në nivel fakulteti në komisionet (ad-hoc) përkatëse për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, monitorimin e procesit të regjistrimeve dhe pranimeve, të kalueshmërisë në vit të studentëve aktivë, etj.

### *3.3 Njësiti administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad- hoc*

**Rektorati/dekanatet** (si njësi administrative), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë zbatuar (vendimet e organeve kolegjiale apo drejtuese) dhe kanë nxjerrë akte rregullative lidhur me procesin e pranimeve dhe regjistrimeve në programet e studimit që ofron UMT-ja apo të transferimeve të studimeve, dhënien e përgjigjes dhe të zgjidhjes për kërkesat/ankesat individuale apo në grup drejtuar UMT-së apo fakulteteve etj.

Gjithashtu, lidhur me organizimin e proceseve nga rektorati/dekanati, nëpërmjet komisioneve ad-hoc të ngritura për aspekte të veçanta të veprimtarisë akademike, evidentojmë se:

- Procesi i përllogaritjes së pikëve të maturantëve dhe rankimit të tyre, në kuadër të pranimeve në programet e studimit në UMT, i kryer nga komisioni i monitorimit dhe grupi teknik (në nivel universiteti), i ngritur për këtë qëllim, është realizuar me sukses.
- Procesi i pranimeve në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë,

që nga nxjerrja e akteve rregullative, procese e aplikimit dhe të konkurrimit të studentëve, si dhe përzgjedhjes së programit specializues afatgjatë nga ana e tyre, kryhet dhe monitorohet tërësisht nga Rektorati i UMT-së dhe dekanatet e fakulteteve përkatëse.

### 3.4 Aktiviteti i njësive kryesore

Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, janë organizuar në njësi bazë (departamente) sipas profilit të fushave të programeve të studimit që ofrojnë apo profilit të veprimtarisë lëndore, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë që departamentet të bashkërendojnë aktivitetet e tyre, në funksion të realizimit të procesit akademik e shkencor.

Po ashtu, departamentet dhe personeli akademik përkatës japin një kontribut të rëndësishëm në angazhimet për institucionin. Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik me kohë të plotë kanë qenë pjesë e komisioneve ad-hoc<sup>3</sup> për proceset e pranimeve të studentëve në tre ciklet e studimit.

Në paragrafët e mëposhtëm jepet në mënyrë të përmbledhur aktiviteti i secilit nga fakultetet e UMT-së (informacioni i detajuar gjendet në raportet vjetore për vitin akademik 2021-2022 të secilit fakultet).

#### 3.4.1 Fakulteti i Mjekësisë<sup>3</sup>

Fakulteti i Mjekësisë ofron programe studimi të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të integruara të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, me kohë të plotë, përkatësisht:

- Programe të integruara të ciklit të dytë, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë Master i Shkencave në “Mjekësi e përgjithshme”* me kohëzgjatje 6 vite akademike, 360 ECTS, dhe *Diplomë Master i Shkencave në “Farmaci”* me kohëzgjatje 5 vite akademike, 300 ECTS;
- Program i ciklit të parë Bachelor, me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS, në përfundim të të cilit studenti pajiset me *Diplomë Bachelor në “Shëndet Publik”*;
- Programe të ciklit të dytë, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë Master i Shkencave në “Shëndet Publik”* me kohëzgjatje 2 vite akademike, 120 ECTS; *Diplomë Master Profesional në “Shëndet Publik”* dhe *Diplomë Master Profesional në “Menaxhim Shëndetësor”* me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 ECTS;
- Programe të ciklit të tretë, *“Specializime Afatgjata”*, në fushën e Mjekësisë (kohëzgjatja 3-5 vjet). Në vitin akademik 2021-2022 janë aktivizuar (studentë të regjistruar në vit të parë) 33 programe të specializimeve afatgjata të ofruara nga ky fakultet.
- Programe të ciklit të tretë *“Doktoratë”*, në total 17 programe ku për vitin akademik 2021-

---

<sup>3</sup> Informacioni është marrë nga Raporti Vjetor 2021-2022, Fakulteti i Mjekësisë UMT


2022 kanë qenë në proces 221 Doktorantë, nga të cilët 42 kanë mbrojtur para jurive dizertacionin e tyre.

- Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka miratuar riorganizimin e programeve ekzistuese të doktoratës pranë FM si dhe ka miratuar hapjen e 3 programeve të reja të përbashkëta “Doktoratë” me Universitetin e Bolonjës, Itali. Aktualisht UMT ka ndërmarrë masat dhe procedurat e nevojshme për aktivizimin e këtyre programeve, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukture.

Në Fakultetin e Mjekësisë, UMT, janë angazhuar **205** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive:

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2021-2022</i>					
	Profesor		Lektor	As. Lektor	
Viti akademik	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	Totali
2021-2022	78	78	41	8	205

### Personel akademik me kohë të plotë 2021-2022



Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FM angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme dhe personel akademik nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU), të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme dhe SSHU, 2021-2022</i>			
Viti akademik	SSHU*	Të jashtëm	Totali
2021-2022	182	80	262

**Personel akademik me kohë të pjesshme dhe SSHU,  
2021-2022**



Në FM zhvillojnë veprimtarinë e mësimdhënies **467** anëtarë të personelit akademik: **205** me kohë të plotë; **182** staf i SSHU (strukturave shëndetësore universitare); **80** me kohë të pjesshme, si dhe 49 personel ndihmës akademik dhe 26 personel administrativ.

Fakulteti i Mjekësisë ka specifikën e vet në angazhimin e personelit të strukturave shëndetësore universitare\* në mbështetje të procesit të mësimdhënies, ku i gjithë personeli i rrjetit spitalor universitar është i angazhuar në proceset e mësimdhënies.

- 38% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor”,
- 38% e personelit akademik kanë Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”,
- 20% e personelit akademik kanë Gradën Shkencore “Doktor”
- 4% e personelit akademik janë “Lektorë”.

Sipas këtyre të dhënave, 96% e personelit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, janë me tituj akademikë dhe grada shkencore.

Ngarkesa mësimore e realizuar sipas cikleve të studimit në FM, për vitin akademik 2021-2022, është si më poshtë:

<i>Ngarkesa mësimore sipas cikleve të studimit</i>		
Nr	Programi i studimit	Ngarkesa mësimore fizike
1	Bachelor	2240
2	PICD	7333
3	Master Profesional (Shëndet Publik dhe Menaxhim Shëndetësor)	1389
4	Master i shkencave	1236
5	Specializim Afatgjatë	165983
6	Doktoraturë	0
<b>TOTAL</b>		<b>178181</b>

Për vitin akademik 2021-2022, studentët e regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Programi	Bachelor	Master profesional	Master i shkencave	SPA
Mjekësi e përgjithshme			284	
Farmaci			103	
Shëndet Publik	20	15	20	
Menaxhim shëndetësor		30		
Specializime				206
<b>Total</b>	<b>20</b>	<b>45</b>	<b>407</b>	<b>206</b>
<i>Të regjistruar në FM , viti i parë, gjithsej 678 studentë</i>				

Studentët që ndjekin aktualisht studimet në FM në të gjitha vitet janë:

Programi	Bachelor	Master profesional	Master i shkencave	DR	SPA
Mjekësi e përgjithshme			1897		
Farmaci			493		
Shëndet Publik	57	15	43		
Menaxhim shëndetësor		30			
Specializime					750
Doktoratë				221	
<b>Total</b>	<b>57</b>	<b>45</b>	<b>2433</b>	<b>221</b>	<b>750</b>
<i>Gjithsej 3506 studentë</i>					

### 3.4.2 Fakulteti i Mjekësisë Dentare<sup>4</sup>

Fakulteti i Mjekësisë Dentare ofron programe të ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të tretë, të organizuara si më poshtë:

- 1 program i integruar i ciklit të dytë, me kohëzgjatje 5 vite akademike, 300 ECTS, në përfundim të të cilit studenti pajiset me *Diplomë Master i Shkencave në “Stomatologji”*;
- 2 programe të ciklit të parë “Bachelor”, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë Bachelor në “Higjienist Dentar”* me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS dhe *Diplomë Bachelor në “Teknike Dentare”* me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS;
- 3 Programe të ciklit të tretë, *Specializime Afatgjata*, në fushën e Mjekësisë Dentare. Për vitin akademik 2021-2022 në Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë aktivizuar, 2 programe specializimi, përkatësisht: *“Terapi Stomatologjike”* dhe *“Pedodonti”*.

Për vitin akademik pasardhës është miratuar:

- hapja e një programi të ri të ciklit të tretë Specializim Afatgjatë në *“Ortodonci”* si dhe 2 (dy) programe të reja të përbashkëta me Universitetin e Chieti, Pescara, si më poshtë:
  - Master Profesional/Master ndërkombëtar i nivelit të parë në *“Higjienë Dentare dhe Terapi Paradontale jo Kirurgjikale”*
  - Master Ekzekutiv/Master ndërkombëtar i nivelit të dytë në *“Implanto Protetikë”*.
- Gjithashtu është miratuar riorganizimi i programit të ciklit të tretë Doktoratë në *“Shkenca Mjekësore Dentare”* me 3 (tre) nënfusha.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 kanë mbrojtur doktoratën 20 doktorantë, nga 25 të cilët ishin në proces.

Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë angazhuar **24** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive:

<sup>4</sup> Informacioni është marrë nga Raporti Vjetor 2021-2022, Fakulteti i Mjekësisë Dentare UMT

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2021-2022 (PAKPI)</i>					
	Profesor		Lektor	As. lektor	Totali
Viti akademik	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	
<b>2021-2022</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>24</b>

Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FMD-së angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme, personel akademik i ftuar (*\*personel akademik i FM-së i cili mbulon lëndë të formimit mjekësor*) dhe personel akademik i huaj, i cili ftohet për të zhvilluar module, cikle leksionesh, numri i të cilëve është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme, 2021-2022 (PAKPj)</i>				
Viti akademik	Të ftuar*	Të huaj	Të jashtëm	Totali
	(Fakulteti i Mjekësisë)			
<b>2021-2022</b>	<b>67</b>	<b>43</b>	<b>101</b>	<b>211</b>

Ngarkesa mësimore e realizuar sipas cikleve të studimit në FMD, për vitin akademik 2021-2022, u realizua e plotë. Më poshtë evidentohet ngarkesa mësimore reale e realizuar nga stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme:

Nr.	Programi i studimit	Ngarkesa mësimore orë të konvertuara
<b>1</b>	PICD, BSC dhe SPA	<b>9206.5</b>

Për vitin akademik 2021-2022, studentë të regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Programi	Bachelor	Master shkencor	SPA
Stomatologji		104	
Teknikë Dentare	35		
Higjenist Dentar	70		
Specializime			7
<b>Total</b>	<b>105</b>	<b>104</b>	<b>7</b>
<i>Të regjistruar në FMD, viti i parë, gjithsej 216 studentë</i>			

Studentë që ndjekin aktualisht studimet në të gjitha vitet janë

Programi	Bachelor	Master shkencor	SPA
Stomatologji		608	
Teknikë Dentare	111		
Higjenist Dentar	213		
Specializime			27
<b>Total</b>	<b>324</b>	<b>608</b>	<b>27</b>
<i>Gjithsej 959 studentë</i>			

### 3.4.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike<sup>5</sup>

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ofron programe studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, të organizuara si më poshtë:

- Programe të ciklit të parë “Bachelor”, me kohëzgjatje 3 vite akademike/180 ECTS (6 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Teknikë Laboratori, Logopedi.
- Programe të ciklit të dytë “Master Profesional”, me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 kredite (8 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Logopedi, Teknikë laborator, Kujdes Paliativ dhe Infermieri Familje.
- Programe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, me kohëzgjatje 2 vite akademike, 120 kredite (6 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Logopedi, Teknik laborator.

Gjithashtu është miratuar riorganizimi i programit të ciklit të tretë Doktoratë në “Shkenca Mjekësore Teknike” me nënfusha.

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë angazhuar **65** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2021-2022 (PAKPI)</i>					
Viti akademik	Profesor	Lektor		As. Lekor	Totali
	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	
<b>2021-2022</b>	<b>4</b>	<b>16</b>	<b>40</b>	<b>5</b>	<b>65</b>

Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FSHMT-së angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme dhe personel akademik nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU) dhe njësi të tjera shëndetësore (shërbimit parësor), të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme, 2021-2022 (PAKPj)</i>				
Viti akademik	Të jashtëm	SSHU +njësi të tjera		Totali
		shëndetësore		
<b>2021-2022</b>	<b>173</b>	<b>112</b>		<b>285</b>

Në FSHMT zhvillojnë veprimtarinë e mësimdhënies në total **350** anëtarë të personelit akademik, me kohë të plotë, personel akademik nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU) dhe njësi të tjera shëndetësore (shërbimit parësor) dhe me kohë të pjesshme.

Për vitin akademik 2021-2022, studentë të regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Viti 2021-2022	Bachelor	Master profesional	Master shkencor
Infermieri	282	88	90
Mami	48	0	10

<sup>5</sup> Informacioni është marrë nga Raporti Vjetor 2021-2022, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike UMT

T. Laboratori	55	19	34
Fizioterapi	58	23	21
T. Imazherie	53	18	24
Logopedi	26	7	12
Kujdes Paliativ		0	
Infermier Familje		14	
Total	<b>522</b>	<b>169</b>	<b>191</b>
<i>Në total 882 studentë të regjistruar në vitin e parë</i>			

Studentë që ndjekin aktualisht studimet në të gjitha vitet janë:

Viti 2021-2022	Bachelor	Master profesional	Master shkencor
Infermieri	827	88	169
Mami	132	0	27
T. Laboratori	156	19	73
Fizioterapi	157	21	55
T. Imazherie	150	17	36
Logopedi	80	7	35
Kujdes Paliativ		0	
Infermier Familje		14	
Total	1502	166	395
<i>Gjithsej 2063 studentë</i>			

Programe të ciklit të tretë “Doktoratë”, në total 8 programe ku për vitin akademik 2021-2022 kanë qenë në proces 73 Doktorantë, nga të cilët 63 kanë mbrojtur para jurive dizertacionin e tyre.

### 3.5 Sekretaritetë mësimore në njësitë kryesore

**Sekretaria mësimore** është njësi në funksion të procesit mësimor dhe studentëve. Personeli i sekretarisë mësimore është përgjegjës për të gjitha procedurat që ka kryer fakulteti gjatë vitit akademik në lidhje me regjistrimet, transferimet dhe procesin mësimor.

Konkretisht, me fillimin e vitit të ri akademik, sekretaria:

- hap regjistrat e notave ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, planeve mësimore për vitet e para, të dyta e në vazhdim, të cilët vazhdojnë studimet në fakultet;
- regjistrat elektronikë ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, planeve mësimore për të gjitha vitet, të cilët vazhdojnë studimet në fakultetin përkatës;
- hedh të dhënat dhe gjeneralitetet e secilit student në Regjistrin Themeltar dhe në formë elektronike, për të mundësuar:
  - pajisjen e tij me numër matrikullimi;
  - aktivizimin e studentit elektronikisht në Sistemin për menaxhimin e të dhënave të studentëve, Pitagora;
- nxjerr statistikat për studentët sipas viteve të studimit (femra/meshkuj; fshat/qytet; trojet, shpërndarja sipas grup moshave për studentët e diplomuar, për studentët që kanë kaluar në vitin pasardhës);
- përgatit regjistrat e pedagogëve me emrat e studentëve sipas programeve të studimit dhe grupeve përkatëse për çdo semestër;
- hedh notat e procesverbaleve të provimeve në regjistrin e notave dhe atë elektronik,

si dhe harton procesverbalet në përputhje me kërkesat me shkrim të studentëve, duke u mbështetur në rregulloren e fakultetit.

Sekretaria mësimore përgatit listat përfundimtare të studentëve që frekuentojnë vitin pasardhës pas përfundimit të sezonit të vjeshtës dhe para fillimit të vitit akademik. Gjithashtu, ajo përgatit certifikatën e notave të studentëve të diplomuar dhe mbledh dokumentet e duhura nga studentët për të gjitha shërbimet e kërkuara nga ana e tyre sipas listës së shërbimeve që ofron UMT-ja.

## IV. VEPRIMTARIA AKADEMIKE

### 4.1 Programet e studimit

UMT-ja në vitin akademik 2021-2022 ka aktivizuar programe studimi **të ciklit të parë me kohë të plotë**, përkatësisht:

- 9 (nëntë) programe studimi Bachelor në
  - Infermieri, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi (FSHMT);
  - Shëndet Publik (FM).
  - Teknikë Dentare dhe Higjenist Dentar (FMD)

UMT-ja në vitin akademik 2021-2022 ka aktivizuar programe studimi **të integruara të ciklit të dytë me kohë të plotë**, përkatësisht:

---

- 3 (tri) programe studimi të integruara
  - Master i Shkencave në Mjekësi e Përgjithshme (FM)
  - Master i Shkencave në Farmaci (FM)
  - Master i Shkencave në Stomatologji (FMD).

UMT-ja në vitin akademik 2021-2022 ka aktivizuar programe studimi **të ciklit të dytë me kohë të plotë**, përkatësisht:

---

- 8 (tetë) programe studimi Master Profesional (60 ECTS)
  - Menaxhim Infermieror, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi dhe Infermieri Familje<sup>6</sup> (FSHMT<sup>7</sup>);
  - Shëndet Publik dhe Menaxhim Shëndetësor (FM).
- 7 (shtatë) programe studimi Master i Shkencave (120 ECTS)
  - Infermieri, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi (FSHMT);
  - Shëndet Publik (FM).

UMT-ja në vitin akademik 2021-2022 ka aktivizuar programe studimi **të ciklit të tretë specializime afatgjata në fushën e mjekësisë dhe stomatologjisë**, përkatësisht:

---

- 35 (tridhjetë e pesë) programe studimi specializime afatgjata në fushën e mjekësisë nga të cilat:
  - 33 programe të specializimeve afatgjata që ofron Fakulteti i Mjekësisë
  - 2 program specializimi afatgjata që ofron Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

---

<sup>6</sup> Ofruar për herë të parë në vitin akademik 2021-2022

<sup>7</sup> Master Profesional në Mami dhe Master Profesional në Kujdes Paliativ nuk janë aktivizuar me student për vitin 2021-2022

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka ofruar gjatë vitit akademik 2021-2022, programe të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë” për doktorantët të cilët janë ende në proces, në tri njësitë kryesore të UMT.

Të gjitha programet ekzistuese të doktoratës i janë nënshtruar procesit të riorganizimit në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe kanë marrë miratimin përfundimtar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Programet e studimit që ofrohen në njësitë kryesore të UMT-së, janë objekt rishikimi periodik (çdo fillim viti akademik), në plotësim të standardeve evropiane dhe atyre shtetërore të cilësisë.

Veprimtaritë formuese janë grupuar në kategori sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018, “*Për elementët e programeve të studimit...*” e ndryshuar, duke i ndarë në *lëndë bazë* të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme; *lëndë karakterizuese*, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij; *lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese* në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje; *lëndë plotësuese*, të fokusuar në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat klinike/profesionale të zhvilluara pranë QSUT-së dhe strukturave të tjera universitare dhe jouniversitare shëndetësore, si dhe *tezën e diplomës dhe/ose provimin përfundimtar*.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, bazuar në strategjinë e zhvillimit 2021-2024 si dhe objektiveve për internacionalizimin e programeve të studimit të UMT, ka miratuar 5 programe të reja të përbashkëta nga të cilat:

2 programe të reja të përbashkëta me Universitetin e Chieti, Pescara:

- Master Profesional/Master ndërkombëtar i nivelit të parë në “*Higjienë Dentare dhe Terapi Paradontale jo Kirurgjikale*”
- Master Ekzekutiv/Master ndërkombëtar i nivelit të dytë në “*Implanto Protetikë*”, si dhe

3 programe të reja të përbashkëta me Universitetin e Bolonjës:

- Doktoratë në “Mjekësi Interne”
- Doktoratë në “Kirurgji e Përgjithshme dhe nënspecialitete”
- Doktoratë në “Obstetrikë-Gjinekologji”

Gjithashtu është miratuar hapja e 1 (një) programi të ciklit të tretë Specializim Afatgjatë në “Ortodonci” në Fakultetin e Mjekësisë Dentare si dhe janë riorganizuar programet ekzistuese të ciklit të tretë “Doktoratë” në të tre njësitë kryesore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## 4.2 *Procesi mësimor, mësimdhënia, vlerësimi dhe pranimet*

Mësimdhënia në njësitë kryesore të UMT-së është organizuar në bazë të veprimtarive formuese dhe përbërësve mësimorë të programit të studimit, të cilët ndahen në mësim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, praktika klinike, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe

seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor, studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës e praktika profesionale.

Ndarja e orëve mësimore në auditor bëhet në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo lëndë/modul, është e përcaktuar në planet mësimore të programeve të studimit, në bazë të krediteve që ka secila lëndë/disiplinë. Procesi mësimor organizohet në përputhje me profilin e disiplinës, veprimtarisë formuese dhe nivelit të programit të studimit. Personeli akademik ka liri të plotë në organizimin e procesit mësimor, në përputhje me planin e miratuar dhe syllabuset e lëndëve.

Në nivel fakulteti kryhen monitorime periodike për të parë realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar. Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe ruajtja e etikës profesionale të personelit akademik ka qenë në fokus të vazhdueshëm nga fakultetet e UMT-së gjatë vitit akademik 2021-2022. Për këtë qëllim njësitë kryesore monitorojnë procesin mësimor, si dhe metodat e mësimdhënies dhe etikës së komunikimit të stafit me studentët, me qëllim vlerësimin në tërësi të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në nivel fakulteti.

Informacion lidhur me metodologjitë e vlerësimit të studentëve gjendet në çdo program studimi, në rregulloren e fakultetit dhe specifikisht në syllabuset e lëndëve/moduleve. Organizimi i provimeve është semestral ose vjetor në varësi të lëndës dhe programit. Vlerësimi i vazhduar i studentëve u realizua sipas përcaktimeve në syllabuset e lëndëve (testeve dhe detyrave të dhëna nga pedagogët e lëndëve), ndërsa vlerësimi përfundimtar i studentëve u krye nëpërmjet provimeve në auditor.

Rezultatet e studentëve në vite, kompetencat dhe aftësitë profesionale të fituara janë në nivel të kënaqshëm dhe përmbushin kërkesat aktuale të tregut të punës në lidhje me nivelin e kualifikimit, që dëshmon se në UMT diplomohen studentë të aftë profesionalisht për të shërbyer në çdo nivel të shërbimit shëndetësor, brenda dhe jashtë vendit.

Nisur edhe nga qasjet e reja, të diktuar nga zhvillimet teknologjike apo edhe vështirësitë e kohës, UMT ka nisur implementimin e një projekti ambicioz të quajtur **e-UMT**, ku do të gërshetohen të gjithë mjetet dhe burimet që UMT disponon, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të gjithë aktivitetit në UMT.

Fokusi i **e-UMT** është **Sigurimi i Cilësisë** (sigurimi dhe përmirësimi; cikli i përmirësimit të vazhdueshëm) në lidhje me mësimin nxënien dhe mësimdhënien, të integruar me kërkimin dhe inovacionin, duke përfshirë mjedisin e punës dhe atë mbështetës. Reagimi i UMT ndaj Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane (Zona Evropiane e Arsimit të Lartë) dhe Kodit Shqiptar të Cilësisë.

Objektivi i këtij projekti është:

- krijimi i një paradigme në zhvillim, të ndryshme dhe të matshme në kohë reale, drejt Cilësisë në Arsimin e Lartë Shqiptar dhe më gjerë.
- zhvillimi i një kulture cilësie që përqafohet nga të gjitha palët e interesuara.

- rritja e burimeve për të mbështetur mësimin nxënien dhe mësimdhënien, kërkimin dhe inovacionin, menaxhimin dhe qeverisjen.
- mbështetja në besimin e ndërsjellët, duke lehtësuar kështu njohjen dhe mobilitetin brenda dhe përtej kufijve kombëtarë.

Për herë të parë, në kuadër të akreditimit periodik institucional në sistemin e menaxhimit e-UMT, u krijua një seksion i veçantë për akreditimin institucional për zhvillimin e veprimtarive, dokumentimin e procesit, takimeve, dokumenteve, si dhe për të lehtësuar komunikimin, informimin si dhe ndërveprimin në kohë reale midis anëtareve të GVB dhe aktorëve të tjerë të institucionit.

Ajo çka na udhëheq në këtë nismë është se UMT-ja ka përgjegjësinë kryesore për cilësinë e edukimit mjekësor dhe ofrimin e tij duke marrë parasysh nevojat dhe pritshmëritë e të gjithë palëve të interesuara në shoqërinë shqiptare dhe përtej saj, në rrugëtimin e saj drejt integritimit në BE.

**Pranimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.** UMT është i vetmi institucion i arsimit të lartë në vend i cili ka përcaktuar si kriter cilësor në hyrje, notën mesatare për aplikim për secilin nga programet e studimit. Me vendim të Senatit Akademik të UMT, bazuar në propozimet e njëjësive kryesore për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023, janë përcaktuar nota minimale mesatare në hyrje, si më poshtë:

- Për programet e integruara të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, “Stomatologji” dhe “Farmaci”  $\geq 8.5$
- Për programet e ciklit të parë  $\geq 7.5$

përkundrejt notës mesatare minimale (7) përcaktuar me VKM Nr.436 datë 03.06.2020.

Për vitin akademik 2022-2023 (pranimet janë kryer ne periudhën gusht-tetor 2022) , numri i aplikantëve për të gjitha programet e studimit në të tri raundet e aplikimit (nëpërmjet portalit U-Albania) ishte **27984** aplikime (rasti kur një aplikant ka përzgjedhur më shumë se 1 (një) program studimi të UMT-së).

Tabela e detajuar e aplikimeve sipas programeve të studimit që ofron UMT-ja, për kandidatët vendas:

##	Programi i studimit	Kuota të miratuar për 2021-2022	Aplikime në tri raundet	Mesatarja e kërkesave për kuotë
1	MSc. Mjekësi e Përgjithshme (PICD)	260	3183	12
2	MSc. Farmaci (PICD)	100	2607	26
3	MSc. Stomatologji (PICD)	100	2888	29
4	Bsc. Shëndet Publik	20	964	48
5	Bsc. Infermieri e Përgjithshme	280	4313	15
6	Bsc. Fizioterapi	55	2905	53
7	Bsc. Mami	45	1044	23
8	Bsc. Teknikë Imazherie	52	3086	59
9	Bsc. Teknikë Laboratori	50	2575	52

10	Bsc. Logopedi	25	1411	56
11	Bsc. Teknikë Dentare	35	2126	61
12	Bsc. Higjenist Dentar	70	882	13
	<b>TOTAL</b>	<b>1092</b>	<b>27984</b>	<b>37</b>

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen vlerat minimale të mesatareve për aplikantët në të gjitha raundet, si dhe mesataret minimale të kandidatëve të shpallur fitues:

<b>Nr</b>	<b>Programi i studimit</b>	<b>Mesatare e MES.VKM</b>	<b>Mesatare e M1 (Gjimnaz)</b>	<b>Mesatare e M2 (Matura)</b>
1	Farmaci	9.36	9.65	9.07
2	Fizioterapi	8.57	8.85	8.29
3	Higjenist Dentar	8.01	8.28	7.75
4	Infermieri e Përgjithshme	8.60	8.91	8.28
5	Logopedi	8.67	9.01	8.33
6	Mami	8.42	8.75	8.10
7	Mjekësi e Përgjithshme	9.43	9.71	9.16
8	Shëndet Publik	8.89	9.18	8.59
9	Stomatologji	9.37	9.66	9.09
10	Teknikë Dentare	8.31	8.63	8.00
11	Teknike Imazherie	8.69	9.00	8.37
12	Teknike Laboratori	8.75	9.07	8.42
	<b>Grand Total</b>	<b>8.83</b>	<b>9.13</b>	<b>8.53</b>

## V. SIGURIMI I CILËSISË

Për të garantuar cilësinë e institucionit dhe programeve të studimit, UMT është pjesë e vlerësimeve periodike në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit. Në vijim të akreditimit të parë institucional në vitin 2017 nga ekspertët e QAA dhe tri akreditimeve me kohëzgjatje maksimale të programeve të integruara të studimit, Msc. Mjekësi e Përgjithshme, Msc. Farmaci dhe Msc. Stomatologji, UMT gjatë vitit akademik 2021-2022 ka realizuar procesin e akreditimit periodik institucional.

Në këtë kuadër, me Urdhër të Rektorit të UMT-së, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i përbërë prej 10 anëtarësh, një prej të cilëve ishte student specializant. Procesi i vlerësimit të brendshëm ka qenë gjithëpërfshirës, duke garantuar transparencë të plotë në veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të vlerësimit të brendshëm. Për këtë qëllim, në sistemin e menaxhimit të UMT (e-UMT), u krijuar një seksion i veçantë për akreditimin institucional për zhvillimin e veprimtarive, dokumentimin e procesit, takimeve, dokumenteve, lehtësimin e komunikimit, informimit, si dhe ndërveprimin në kohë reale midis anëtareve të GVB dhe aktorëve të tjerë të institucionit.

Në zbatim të agjendës paraprahe të dërguar nga ASCAL, pas dërgimit të RVB-së dhe dosjes së akreditimit, u realizua vlerësimi i jashtëm nga ekspertët e përzgjedhur nga ASCAL, procedurë e cila u finalizua me vizitën në UMT, në datat 23-24 qershor 2022. Gjatë këtyre dy ditëve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm realizoi takime të njëpasnjëshme, duke nisur me Rektorin e UMT-së, GVB-në, anëtarë përfaqësues të organeve kolegjiale të UMT-së, stafit akademik, studentëve, administratës dhe grupe të tjera të interesit.

Ky proces u finalizua me Raportin Përfundimtar të Vlerësimit të Jashtëm, ku rezultoi se UMT ka përmbushur plotësisht (vlerësimi maksimal, sipas shkallës së vlerësimit) Standardet Shtetërore të Cilësisë për vlerësimin institucional në të pesë fushat e vlerësimit. GVJ evidentoi 12 praktika të mira të ndjekura nga UMT, 1 rekomandim dhe asnjë pikë të dobët. Në përmbushje të rekomandimit të lënë, për pasurimin e faqes zyrtare të UMT me materiale në gjuhën angleze, UMT po harton planin e punës në kuadër të përmirësimit.

Aktualisht, UMT është në pritje të Vendimit të Bordit të Akreditimit, lidhur me vlerësimin përfundimtar dhe kohëzgjatjen e akreditimit.

Në zbatim të objektivave të strategjisë së institucionit, për vitin akademik 2022-2023, UMT do të vijojë me planin për akreditimin e të gjitha programeve të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (19 programe). Gjithashtu, në vitin pasardhës, UMT do t'i nënshtrohet akreditimit të programeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë të Fakultetit të Mjekësisë (4 programe) dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare (2 programe).

## VI. PERSONELI AKADEMIK


### 5.1 Personeli akademik

Në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në total **1052** anëtarë të personelit akademik përkatësisht personel akademik me kohë të plotë (PAKPI), personel akademik që vijnë nga struktura shëndetësore universitare dhe jouniversitare (PASSHU)+ te ftuar dhe personel akademik me kohë të pjesshme (PAKPj), si më poshtë:


Personeli akademik i angazhuar në 2021-2022, në UMT	Numri total
Me kohë të plotë (PAKPI)	294
SSHSU <sup>8</sup> dhe SSHJSU (PASSHU)+Të ftuar	404
Me kohë të pjesshme (PAKPj)	354
<b>TOTALI</b>	<b>1052</b>

Numri i anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programet e studimit që ofron UMT-ja është **294**.

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2021-2022 (PAE)</i>					
Njësia kryesore	Profesor		Lektor Dr.	As. Lektor ose Master	Totali
	Prof.	Prof. Asc.			
<b>Fakulteti i Mjekësisë</b>	78	78	41	8	205
<b>Fakulteti i Mjekësisë Dentare</b>	5	6	12	1	24
<b>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike</b>	4	13	41	7	65
<b>TOTAL</b>	<b>87</b>	<b>97</b>	<b>94</b>	<b>16</b>	<b>294</b>



Nga të dhënat e tabelave të mësipërme rezultojnë se **95%** e të gjithë personelit akademik me kohë të plotë në nivel universiteti janë me tituj akademik ose gradë shkencore (**30%** janë me titull “Profesor”, **33%** me titullin “Profesor i Asociuar” dhe **32%** me gradën shkencore “Doktor”).



Referuar të dhënave nga sektori i burimeve njerëzore, evidentohet se të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë në UMT plotësojnë detyrimin ligjor për sa i përket personelit akademik dhe titujve akademikë dhe gradave shkencore.

UMT-ja, ka në përbërje të saj strukturat shëndetësore universitare (ligji nr. 80/2015, neni 28) dhe departamentet, si njësi bazë, kanë në përbërjen e tyre shërbime dhe specialitete të ndryshme, në varësi të funksionit të veprimtarisë së tyre. Shërbimet kryejnë funksion të dyfishtë: akademik dhe kërkimor-shkencor si njësi akademike të UMT-së, si dhe shërbim terciar, diagnostikues e trajtues, si njësi të strukturës shëndetësore universitare spitalore të sistemit shëndetësor në vend. Në bazë të kësaj strukture, kryhet aftësimi akademik, praktik e klinik i studentëve, specialistëve, si dhe veprimtaria kërkimore-shkencore e doktorantëve dhe e personelit akademik, si dhe njëkohësisht ofrohet shërbim shëndetësor ndaj popullatës.

Nisur nga kjo formë organizimi dhe funksionimi, praktikisht e gjithë infrastruktura dhe kapacitetet njerëzore të qendrave spitalore universitare në vend, përveç ofrimit të shërbimit shëndetësor, janë njëkohësisht në funksion të edukimit e kërkimit shkencor mjekësor, si pjesë e UMT-së (VKM-të përkatëse për krijimin e strukturave shëndetësore universitare në vend). Në këtë kuadër, në mbështetje të procesit mësimor në UMT, për vitin 2021-2022 janë angazhuar si personelit mbikëqyrës akademik (SSHU), të punësuar më kohë të plotë në strukturat shëndetësore në vend.

Personel akademik i ftuar dhe i huaj i angazhuar në UMT janë 15%, personel akademik me kohë të pjesshme (që vijnë nga IAL-të e tjera) të angazhuar për vitin akademik 2021-2022 janë 47% dhe SSHU + struktura të tjera 38 %.

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme në UMT, për vitin akademik 2021-2022 (PAKPj)</i>					
Njësia kryesore	Të jashtëm	SSHU + Str. të tjera	Të ftuar	Të huaj	Totali

		shëndetësore			
Fakulteti i Mjekësisë	<b>80</b>	182			262
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	<b>101</b>		67	43	211
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	<b>173</b>	112			285
<b>TOTAL</b>	354	294	67	43	758

*\*Staf akademik me kohë të plotë i Fakultetit të Mjekësisë që jep mësim edhe pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare*

Procedura për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të pjesshme kryhet çdo vit në përputhje me nevojat që kanë njësitë bazë për mbulimin e ngarkesës mësimore. Në fillimin e vitit akademik 2021-2022, procedura për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të pjesshme u bë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Ngarkesa mësimore është planifikuar dhe realizuar në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtaritë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, për vitin akademik 2021-2022.

## VII. KËRKIMI SHKENCOR<sup>9</sup>

### 6.0 Kërkimi shkencor dhe Titujt akademik

Komisioni i Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë është organi kolegjal përgjegjës për promovimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Ky Komision përbëhet nga 15 anëtarë. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Promovimit të personelit Akademik në UMT vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik nëpërmjet procesit të votimit për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e KPPA-së mbajnë titullin Profesor. KPPA ka marrë 86 vendime për vitin akademik 2021-2022. Gjithashtu, kanë fituar titullin akademik “Profesor” 4 kandidatë dhe “Profesor i Asociuar” 26 kandidatë.

Gjithashtu nga komisionet e doktoratave të ngritura në nivel njësie kryesore ka vijuar procesi i mbrojtjes së doktoratave nga të cilat 70 prej tyre kanë përfunduar të gjithë procesin e vlerësimit.

### 6.1 Fakulteti i Mjekësisë

#### Leksione të hapura nga Fakulteti i Mjekësisë, për vitin 2021-2022

Titulli i Aktivitetit	Data
“A short history of immunizations what is a person to do with SARS-Cov2”- Gary Russell, MD, CMD	20.10.2021
“Who can you trust? Finding factual medical and public health information in an Era of Misinformation”- Prof. Melissa Perry, MD, PhD	2.11.2021
“Albanian Health Fund Plenary Lectures”	7.12.2021
“Klase e hapur”	16.12.2021
“Mbi rëndësinë e kontrollit dhe parandalimit të Sëmundjeve jo të Transmetueshme”- Prof. David Beran, Universiteti i Gjenevës	31.01.2022
“Extracorporal membrane oxygenator, prezantuar nga Dr. Spyridon Loggos	25.03.2022
Inteligjenca emocionale, S’ Liston, G. Bicknell dhe V. Bicknell”	29.03.2022
“Trajnim i politikbërësve mbi natyrën, parandalimin dhe trajtimin e crregullimeve të lidhura me përdorimin e drogave”	12.04.2022
“Obesity, it is a Big problem”- Gary Russell, MD, CMD	05.05.2022
“Teamëork in Medicine”- Prof. Henry Marsh	19.05.2022
“Surgery for Pain Syndromes”- Prof. Arnold Lee Dellon	29.05.2022
“Molecular probes for early diagnosis”- Dr. Gianluca Pozzi	3.06.2022
“Merr kohë për mirëqënien tënde mendore”	7.06.2022
“Shkrimi Akademik” – Prof. Ilir Alimehmeti	14.06.2022
“Roli i kompanive farmaceutike R&D në këshillimin dhe edukimin e brezave të rinj të profesionistëve të shëndetit”	27.06.2022
“Zbulimi I barnave neuropsikiatrike me veprim të shpejtë tek sëmundja e depresionit rezistente në trajtim: Mësimet e nxjerra nga modulimi i neurotransmitemve esenciale në tru- MD Bashkim Kadriu	19.07.2022

<sup>9</sup> Bazuar në informacionin e përcjellë nga Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Rektori i UMT

<sup>4</sup> Raportet e njësisë kryesore për kërkimin, projektet dhe edukimin në vazhdim

## Aktivite të tjera

Aktivite të tjera	Data
Dita botërore e Hemofilisë	17.04.2022
Promovim: New Bulletin of Medical Sciences- Prof. Suela Kellici	24.04.2022
40- vjetori i diplomimit të brezit të studentëve 1976-1982	4.06.2022
Aktiviteti “Bëhu hero-shpëto jetë-dhuro gjak”	14.06.2022
Takim me përfaqësues të Elsevier “Elsevier Research Connect 2022”	04.10.2022

## Lista e aktiviteteve të Edukimit në vazhdim, për vitin 2021-2022

Nr.	Titulli i aktivitetit	Data e aktivitetit
1	Inflamacioni dhe Roli i imunitetit	Tetor 2021
2	Hipertensioni dhe dislipidemia:shkaqet, diagnostikimi dhe terapia	Shtator-Tetor, 2021
3	Dislipidemie dhe kompleksiteti I trajtimit te tyre	29 Shtator 2021
4	Perditesim lidhur me vitaminen D	25 Tetor 2021
5	Njohja dhe trajtimi i disa patologjive mjekesore ne praktiken e perditshme	14 Tetor 2021
6	Njohja dhe trajtimi I semundjeve ne fushen psikiatrike dhe neurologjike	22 Tetor 2021
7	Hepatiti B dhe C	22-29 Tetor 2021
8	Imuniteti dhe semundjet infektive	10-25 Nentor 2021
9	Manaxhimi I urgjences kirurgjikale traumatike dhe jotraummatike, dhe jo vetem"	12-13 nentor 2021
10	Konferenca Kombetare e Endokrinologjise takimi Vjeshte 2021	30 tetor 2021
11	Spektrumi I preeklampsisë- çrregullimet hipertensive të shtatzanisë	10-11 dhjetor 2021
12	Standarte transfuzionale nga dhurimi në përdorim	15 dhjetor 2021
13	Roli i biomarkuesve të profilit lipidik dhe korrelacioni për zhvillimin e sëmundjeve kardiovaskulare	12 shkurt 2022
14	Inovacioni në trajtimin dhe menaxhimin e ASCVD dhe dislipidemive	15 shkurt 2022
15	Njohja dhe trajtimi i disa sëmundjeve në fushën e alergologjisë dhe të ORL	24-25 shkurt 2022 09-31 mars 2022
16	Hipertensioni dhe dislipidemitë në sëmundjen renale kronike	10 mars 2022
17	Efektet imunomodulare të laktoferrinës në pediatri	2 prill 2022
18	Sfidat e menaxhimit ASCVD dhe dislipidemive: të rejat mbi trajtimin e tyre	24 mars 2022
19	Roli i Mjekësisë Laboratorike në menaxhimin e pandemisë të COVID-19	16 prill 2022
20	Akademia e Nefrologjisë- glomerulonefritet dhe dislipidemia	30-31 mars
21	Menaxhimi i alergjisë nga Farmacisti	28 prill 2022
22	Konferencë Shkencore	22 prill 2022
23	Konferenca e 28 e Kirurgjisë Shqiptare	20-21 maj 2022
24	Parandalimi dhe kontrolli I ASCVD: një prioritet i sëmundjeve jo të transmetueshme (SJT)	29 prill 2022 26 maj 2022
25	Konferenca e Përbashkët e Shoqatës Spanjolle dhe Shqiptare të Neurokirurgjisë Neurokirurgjia e së ardhmes	3 qershor 2022
26	Update të fundit në okulistikë	27-28 maj 2022

27	Anemia në sëmundjen renale kronike: rekomandimet terapeutike dhe sfidat e reja të trajtimit	2 qershor 2022
28	Roli i Mjekësisë Laboratorike në menaxhimin e sëmundjeve kardio-vaskulare	11 qershor 2022
29	Njohja dhe trajtimi I disa patologjive mjekësore dhe ndikimi I tyre në jetën e pacientëve	31 maj 2022
30	Konferenca Kombëtare endokrinologji dhe diabetologji, takimi I pranverës 2022	4-5 qershor 2022
31	Merr kohë për mirëqënien tënde mendore	7 qershor 2022
32	Të rejat mbi trajtimin konservativ dhe kirurgjikal të sëmundjes së Parkinsonit	14 qershor 2022
33	Njohja dhe trajtimi i sëmundjeve në fushë psikiatrike dhe neurologjike	19 korrik 2022
34	Sfidat e shëndetit mendor në një realitet të ri	15 korrik 2022
35	Evidencat kryesore mbi terapitë antitrombotike	29 qershor 2022
36	Kongresi i 9-te i Mjekësisë Perinatale për Europen Juglindore dhe Kursi i 7-te i Avancuar i ekografisë në Obstetrike-Gjinekologji	29-30 shtator 2022, 1 tetor 2022
37	Nefropatia diabetike- e ardhmja është tani	5 tetor 2022
38	Njohja dhe trajtimi i sëmundjeve në fushën e neurologjisë dhe atë të otorinolaringologjisë	20 tetor 2022
39	Konferenca Kombëtare Vjetore e XVIII, Endokrinologji dhe Diabetologji	29 tetor 2022

### 6.3 Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Fakulteti i Mjekësisë Dentare gjatë vitit akademik 2021-2022 ka pasur një sërë aktivitete të larmishme sociale, shkencore dhe profesionale, lidhur me mundësi të trajnimit të studentëve dhe të stafit, pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, përfaqësim i FMD me studentë në konkurse ndërkombëtare etj.

#### Trajnime dhe mobilitete të stafit akademik dhe studentëve

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Gjenevës, në partneritet me Klinikën Universitare të Mjekësisë Dentare në Universitetin e Gjenevës, ofroi mundësinë e ndjekjes së Masterit të Estetikës për një periudhë një javore, në CUMD, për tre studente të viteve të larta të Fakultetit të Mjekësisë Dentare. Studentet patën mundësinë të asistojnë e të ndiqnin raste të ndryshme klinike në Departamentin e Masterit në Dentistrinë Estetike Mikroinvazive dhe në Departamentin e Masterit të Integruar në Stomatologji. Gjatë kësaj periudhe, studentet e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, ndoqën leksione të fushës së Dentistrisë Estetike nga Dr. Giovanni Tommaso Rocca dhe të implantologjisë nga Dr. Mark Bischof.



- Në datat 7 dhe 9 prill 2022 Fakulteti i Mjekësisë Dentare në bashkëpunim me Fondacionin Humanitar “Operation Smile”, kryen konsulta dhe vizitave falas me paciente me *labio palate schisa* në ambientet e Repartit të Kirurgjisë OMF në Spitalin Francez, si dhe leksione për stafin, specializantët dhe studentët e stomatologjisë.



- Në shtator 2022 nisi konkretizimi i marrëveshjes midis Rutgers School of Dental Medicine dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare, me vizitën e një anëtarë të stafit akademik dhe të një studenti të vitit të fundit në Rutgers School of Dental Medicine.



- Me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit Oral, në 20 Mars 2022, ashtu si çdo vit, pedagogë nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare, në bashkëpunim me Shoqatën Dentare të Dentistrisë Pediatrike dhe me Klinikën Stomatologjike Universitare, zhvilluan një aktivitet me fëmijët e moshës parashkollore në kopshtin MaxWell. Studentët e vitit të pestë, të drejtuar nga pedagogët Dr. Enida Petro dhe Dr. Manola Kelmendi, promovuan rëndësinë e shëndetit oral që në moshat e vogla dhe kujdesin që duhet treguar për dhembet që në fëmijëri.



- Në kuadër të programit Erasmus + u realizua mobiliteti për stafin akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me Universitetin e Mjekësisë dhe Farmacisë Kraiové, Rumani për vitin akademik 2021-2022.



- Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare ekipi i miqve dhe i kolegëve nga Albanian Health Fund dhe Dr. Stomatolog Luke PARKER zhvilluan leksione mjaft interesante mbi përgatitjen e punimeve dixhitale mbi implante me titull "*Digital workflow in implant and restorative dentistry*". Gjithashtu, u zhvillua një konferencë ku u mbajtën leksione për studentët nga mjekët amerikanë Al Weir, Gary Russell, Randy Thompson, Eugene Smith, Robert Chandler, Joshua Evans, Luke Parker, Marc Johnston, Mary Kwok, Catherine Cowles, Christi Park, Timothy Call, Ryan Kwok.
- Në Dhjetor 2021, ekipi i Albanian Health Fund zhvilloi në Fakultetin e Mjekësisë Dentare një leksion mjaft interesant nga Prof. Gary Russel mbi "Manifestimet orale të patologjive të përgjithshme".



- Në datat 11-13 shtator 2022 u zhvillua konkursi “Jules Allemand Trophy”, edicioni i 18, ku prej 5 vitesh Fakulteti i Mjekësisë Dentare përfaqëson Shqipërinë në këtë konkurs ndërkombëtar. Si Fituesit e vendit të parë të edicionit të kaluar, edhe këtë vit u bë një përfaqësim dinjitoz nga studentja e vitit të 5, Elisa Cesaj dhe tutorja Dr. Eris Kotorri.



- Në kuadër të Projektit READ të ofruar nga AADF, fituar nga staf i FMD dhe KSU në bashkëpunim me mjekë të diasporës, konkretisht me PhD. Bruna Sinjari, nga Universiteti “Gabriele d’Annunzio” Chieti Pescara, është duke zhvilluar një studim mjaft interesant mbi precizionin e koronave të zirkonit. Lidhur me këtë studim, mjekja stomatologe nga Universiteti i Chietit, PhD. Bruna Sinjari, zhvilloi leksionin e parë mbi këtë studim lidhur me përdorimin e teknologjisë dixhitale dhe sistemeve CAD-CAM në ditët e sotme. Studimi do të vijojë si një projekt i ndërsjellë midis dy universiteteve dhe dy fakulteteve të stomatologjisë.



- Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe UMT me Qendrën Universitare Charite' Berlin, të iniciuar që në tetor 2016, një ekip nga FMD, UMT, i përbërë nga anëtarë të Dekanatit të FMD dhe Rektoratit të UMT, si dhe përfaqësues të Ambasadës tonë në Berlin, zhvilloi një vizitë zyrtare në Charite' dhe një takim me Drejtorin e kësaj qendre, Prof. Dr. Florian Beuer, i cili tashmë prej 5 vitesh ka një bashkëpunim të gjerë e aktiv me FMD dhe drejtuesit e këtij Fakulteti.
- Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Prof. Beuer dhuroi për bibliotekën dhe studentët e FMD shumë libra didaktikë bashkëkohorë “All ceramics at a glance”, mbi të gjitha llojet e punimeve protetike të porcelanit.

## Konferenca/Kongrese

- Në datat 8-11 shtator 2022, në Bari, Itali, u zhvillua me sukses Kongresi i IV Ndërkombëtar me tematikën “Të rejat teknologjike dhe protokollet eksperimentale në paradontologji, kirurgji orale dhe ortognatodonci”. Ky kongres u organizua nga Universiteti “Aldo Moro” Bari, Poliklinika e Barit, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, dhe me FMD, si dhe me universitete të tjera të njohura ndërkombëtare.
- Në 12-14 Maj 2022, u organizua Konferenca e Shkencave Mjekësore 10, me një pjesëmarrje aktive dhe kontribut madhor të FMD. Tematika kryesore e këtij Eventi ishte “Mjekësia dhe Stomatologjia në periudhën post-Covid”.



- Në datat 19-21 Nëntor 2021, u zhvillua takimi i IV të Stomatologëve Shqiptarë si dhe Konferenca e Shkencave Mjekësore IX ku morën pjesë 50 profesorë, akademikë dhe profesionistë nga Universiteti “Aldo Moro”, Bari, Universiteti “Gabriele d’Annunzio”, Chieti-Pescara, si dhe nga universitete të tjera ndërkombëtare e kombëtare.



## Projekte

- Është fituar projekti “Aplikimi i teknologjisë dixhitale në Stomatologji” në bashkëpunim me AKKSHI.
- Është fituar projekti “Vlerësimi i urave metal qeramikë mbi implante” në bashkëpunim me AKKSHI.
- Është fituar projekti “Krahasimi në metodat e polimerizimit të protezave” në bashkëpunim me AKKSHI.
- Jemi partner si pjesë e Projektit BIOSINT të fituar nga Universiteti i Sarajevës, projekt i BE
- Vijon bashkëpunimi me Universitetin Aldo Moro të Barit, Itali, në aspektin e mobilitetit të stafit, studentëve dhe kërkimit shkencor.
- Vijon bashkëpunimi për realizimin e projektit të financuar nga GIZ me Universitetin Charite Berlin, Gjermani.

## Aktiviteti kërkimor shkencor

Nr.	Aktivitete/Veprimtari	FMD
1	Botime në revista shkencore brenda vendit	13
2	Botime në revista shkencore jashtë vendit	32
3	Referime në Konferenca/Seminar shkencor brenda vendit	40
4	Referime në Konferenca/Seminar shkencor jashtë vendit	24
5	Botim librash/monografi shkencore	6

## 6.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Gjatë vitit akademik 2021-2022 stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike është angazhuar në aktivitete të edukimit në vazhdim, aktivitete kërkuese dhe botime, me qëllim final përmirësimin e kapaciteteve akademike.

Për vitin akademik 2021-2022, veprimtaria shkencore ka qenë e fokusuar në atë individuale dhe atë në bazë Fakulteti.

Në mënyrë individuale pedagoget e departamenteve janë angazhuar në aktivitete shkencore, ku përfshihen pjesëmarrje, apo paraqitje punimesh dhe referimesh shkencore, në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në përmbushje të detyrimeve të edukimit në vazhdim.

Lista e aktiviteteve të Edukimit në vazhdim, për vitin 2021-2022

Nr.	Titulli i aktivitetit	Data e aktivitetit
1	Konferenca e 3-të e Shkencave Teknike dhe Diagnostikuese, sfida dhe prespektiva	9-10 dhjetor 2021
2	Konferencë Shkencore	22 prill 2022

## Projekte dhe Trajnime:

DDRSHIKIOGJ ka pjesëmarrje në 3 projekte ndërkombëtare, nga Akademia e Shkencave si bashkëpunim me të tretët:

- Studimi seroepidemiologjik i gjendje imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 në popullatën shqiptare, Akademia e Shkencave
- Development of simulation and forecasting models and integration with# TCIA database of medical images, pjesë e projekteve të READ
- Trajnimi në kërkim shkencor prej 60 orësh nga HAP&Shëndet Publik,.

## 6.4 Bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel universiteti

Informacion mbi bashkëpunime ndërinstytucionale dhe projekte ku merr pjesë Universiteti i Mjekësisë, Tiranë <sup>10</sup>							
Nr.	Informacion mbi institucionin bashkëpunues apo projektin	Lloji i kontratës	Data e nënshkrimit	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit	Fusha e bashkëpunimit	Detyrat e palëve dhe produktet	Rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim
1	Universiteti La Sapienza, Romë, Itali	Marrëveshje kuadër	31.03.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional
2	Universiteti Ndërkombëtar i Shkencave të Shëndetit "Saint Camillus", Itali	Marrëveshje kuadër	07.03.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional
3	Universiteti i Mjekësisë dhe Farmacisë së Kraiovsës, Rumani	Marrëveshje kuadër	20.04.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional
4	Universiteti i Chieti, Pescara, Itali	Marrëveshje kuadër	26.04.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional
5	Universiteti Polis	Marrëveshje kuadër	20.04.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional

<sup>10</sup> Bazuar në informacionin e përcjellë nga Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Rektorati i UMT

6	Oda e Farmacistëve të Kosovës	Marrëveshje kuadër	31.03.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional
7	Organizatë jo-fitimprurëse Akademi Foundation	Marrëveshje kuadër	07.03.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional
8	Western balkans University	Marrëveshje kuadër	21.11.2022	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional

### Projekte (përmbledhje e projekteve të tri njësive kryesore dhe rektoratit)

- Përfundoi projekti GRADUA në kuadër të Erasmus+ Capacity Building, duke përmbushur të gjitha detyrimet si partner.
- Gjithashtu, u dorëzua raporti final dhe për projektin EUSCREEN.
- Ka përfunduar projekti i UMT me UNICEF “*Strength Infection Prevention and Control in Healthcare facilities*” ref: ALB/PCA202222/HPD202220 me UNICEF, zbatuar në periudhën shkurt-shtator 2022.
- Ka vazhduar zbatimin e Projektit QUADIC me koordinatoret e Universitetit “Kadri Zeka”, Gjilan. Janë zhvilluar disa takime on-site dhe online të grupit të punës. Në kuadër të këtij projekti, në UMT kanë ardhur pajisje teknologjike që do të shfrytëzohen nga stafi i UMT për aktivitete të ndryshme. Në Tetor 2022 u zhvillua në ambientet e Rektoratit event i radhës në kuadër të këtij Projekti, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Universitetet partnere. Gjithashtu, pjesëtarë të stafit akademik dhe administrativ kanë ndjekur eventet e organizuara nga partnerët Shqiptarë apo të huaj të këtij Projekti.
- Ka vazhduar zbatimin e Projektit IDEA në kuadër të Erasmus+ Capacity Building, me koordinatoret e Universitetit “POLIS”, Tiranë. Janë zhvilluar dy takime hibride. Gjithashtu, pjesëtarë të stafit akademik dhe administrativ kanë ndjekur eventet e organizuara nga partnerët Shqiptarë apo të huaj të këtij Projekti.
- Filloi zbatimin e Projektit DigiCare4You – Endokrinologji, në kuadër të Horizon 2020.
- Është aplikuar si partner për projektin L3ad, në kuadër të Erasmus + Capacity Building, i cili në fazën e parë është refuzuar, por po ripunohet për të aplikuar sërish.
- Është fituar projekti “Aplikimi i teknologjisë dixhitale në Stomatologji” në bashkëpunim me AKKSHI.
- Është fituar projekti “Vlerësimi i urave metal qeramike mbi implante” në bashkëpunim me AKKSHI.
- Është fituar projekti “Krahasimi në metodat e polimerizimit të protezave” në bashkëpunim me

## AKKSHI.

- FMD është partner në Projektin BIOSINT të fituar nga Universiteti i Sarajevës, projekt i BE.
- Vijn bashkëpunimi i FMD për realizimin e projektit të financuar nga GIZ me Universitetin Charite Berlin, Gjermani.
- Shërbimi i Alergologjisë: “Efektet afatmesme dhe afatgjata të infeksionit nga SARS-COV-2 në funksionin pulmonar tek moshat e reja post Covid-19 në Shqipëri. Determinimi i rolit të atopisë dhe sensitivizimit nga pneumoalergenët, si tregues i mbizotërimit inflamacionit TH2 në raport me severitetin klinik të COVID-19 në këtë popullatë”
- Departamenti i Farmacisë ka vazhduar zbatimin e projektit, në bashkëpunim me Milanon.
- Studimi seroepidemiologjik i gjendje imunitare ndaj virusit SARS-COV-2 në popullatën shqiptare, Akademia e Shkencave.
- “Development of simulation and forecasting models and integration with# TCIA database of medical images”, pjesë e projekteve të READ.
- Në kuader të bashkëpunimit me Kompaninë farmaceutike Fidia Pharma me qendër në Padova, Itali, u zhvilluan disa etapa për përzgjedhjen e 6 studentëve të ekselencës së vitit V, Fakulteti i Mjekësisë, të cilët zhvilluan internship 4 javor në Shtator 2022 në Kompaninë Fidia Pharma.
- Shërbimi i Nefrologjisë përfundoi me sukses nivelin C, me kohëzgjatje 2-vjecare në kuadër të binjakezimit me Shërbimin e Nefrologjisë Wurzburg, Gjermani, financuar nga Shoqata Botërore e Nefrologjisë (ISN). Në kuadër të këtij binjakëzimi u zhvilluan dy Konferenca Multidisiplinare, me pjesëmarrjen e Presidentit të Shoqatës Evropiane të Nefrologjisë (ERA), Prof. Christoph Wanner, për të cilat u bë jehonë dhe në faqen zyrtare të ERA. Ky program binjakezimi fitoi të drejtën e vazhdimin në nivelin B, me kohëzgjatje për dy vjet.

List of International Projects					
Participant	Project Reference No and Title, Funding programme	Period (start and end date)	Role (COO, BEN, AE, OTHER)	Amount (EUR)	Website (if any)
UMT	<b>EUSCREEN</b> (Implementation of cost-optimized childhood vision and hearing screening programmes in middle-income countries in Europe) – <b>Horizon2020</b> ; No: 733352	2016-2020 (perfunduar me 2021)	BEN	817050,00 Euro	www.euscreen.org
UMT	<b>GRADUA</b> (Capacity Building) - GRaduates Advancement and Development of University capacities in Albania. No: 585961-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-SP	2017-2021	BEN	52147,00 Euro	http://www.graduaproject.com

UMT	<b>QUADIC</b> 609786-EPP-1-2019-1-XK- EPPKA2-CBHE-JP Quality development of international cooperation and project management	2019-2022	BEN	54000,00 Euro	<a href="https://quadic.net/">https://quadic.net/</a>
UMT	<b>DigiCare4You</b> (An intersectoral innovative solution involving DIGital tools, empowering families and integrating community CARE services for the prevention and management of type 2 diabetes and hypertension)  <b>(H2020-SC1-2020-Two- Stage-RTD) Project No: 945246</b>	2021-2025	BEN	232 412,16 Euro	<a href="https://digicare4you.eu">https://digicare4you.eu</a>
UMT	<b>Central European Initiative (CEI)</b> , in cooperation with Regio Emilia, Italy and Ministry of Health and Social Protection, Albania. Ref. No. 305.3763-20	2020-2021	BEN	5890,00 Euro	<a href="http://umed.edu.al">umed.edu.al</a>
UMT	<b>IDEA</b> Inclusive Tertiary Education in the West BalkanS  EAC-A02-2019-CBHE	2021-2023	BEN	74000,00 Euro	<a href="http://idea-cbhe.com">http://idea-cbhe.com</a>
UMT	<b>UNICEF</b> Strength Infection Prevention and Control in Healthcare facilities	2022	BEN	6`558`o88 ALL	<a href="http://umed.edu.al">umed.edu.al</a>
UMT	<b>AUF</b> Etude de la réponse immunitaire à l'infection par le virus SARS-CoV-2 dans la population albanaise: Implications pour la campagne de vaccination et la planification des mesures pour prévenir et limiter l'infection COVID-19.	2021-2022	BEN	19990,00 Euro	<a href="http://www.auf.org">www.auf.org</a>

## 6.5 Shkëmbimet në kuadër të Programit Erasmus+

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë bashkëpunon me disa universitete të huaja, në kuadër të programit Erasmus+ dhe shkëmbimit të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ.

Për vitin akademik 2021-2022 UMT ka pasur marrëveshje aktive me:

1. Universiteti i Mjekësisë së Grazit, Austri
2. Universiteti i Saarlandit, Gjermani
3. Universiteti i Kamerinos, Itali
4. Universiteti i Aquilas, Itali
5. Universiteti "Ondokuz Mayıs", Samsun, Turqi

6. Universiteti i Craioves, Rumani
7. Universiteti i Bolonjes, Itali
8. Universiteti i Ferrares, Itali
9. Universiteti i Wrocław, Poloni
10. Universiteti i Granades, Spanjë
11. Universiteti i Tor Vergata, Itali
12. Kolegji Univesitar, Vukovar, Kroaci

Numri i shkëmbimeve të kryera në vite, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Nga UMT në Universitetet e huaja

<b>Kuota për</b>	<b>2021-2022</b>
Specializante	5
Staf akademik	20
Studentë	16
Staf administrativ	9
<b>Total</b>	<b>50</b>

Nga Universitetet e huaja në UMT

<b>Kuota për</b>	<b>2021-2022</b>
Staf akademik	16
Studentë	4
Staf administrativ	1
<b>Total</b>	<b>21</b>

<b>Kuota për</b>	<b>Kohëzgjatja mesatare e mobilitetit</b>
Specializantë	2-6 muaj
Staf akademik	7 ditë
Studente	2-6 muaj
Staf administrativ	7 ditë

Në Tetor 2022, në ambientet e Rektoratit u zhvillua aktiviteti “Ditët Erasmus”, ku morën pjesë studentë, staf akademik dhe administrativ, të cilët ndanë eksperiencën e fituar në mobilitetet që kishin kryer në kuadër të programit Erasmus+ në Universitete të huaja.



## 6.6 Anëtarësimi i UMT-së në rrjete ndërkombëtare

**Balkan Universities Association (BUA):** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtar me të drejta të plota në Shoqatën e Universiteteve të Ballkanit (BUA). BUA është një rrjet universitar, që përbëhet nga 66 universitete anëtare dhe përfshin vendet e Ballkanit dhe Evropës Lindore. Ky rrjet është krijuar për të mundësuar lidhje të ngushta mes universiteteve të Ballkanit në ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit, shkëmbimin studentor dhe të personelit akademik, si dhe në punimet e përbashkëta shkencore.

**Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF):** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtar i këtij rrjeti në cilësinë e anëtarit vëzhgues. Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF), e krijuar 50 vite më parë, bashkon mbi 800 universitete nga më shumë se 100 vende të botës, rrjete universitare, qendra kërkimore-shkencore dhe përfaqëson një nga agjencitë më të mëdha të institucioneve të arsimit të lartë në botë.

**UNIADRION:** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtarësuar në UNIADRION, që përfaqëson një shoqatë universitetesh dhe qendrash kërkimore të zonës adriatiko-joniane, themeluar në vitin 2000. Qëllimi i UNIADRION-it është bashkëpunimi midis universiteteve dhe qendrave kërkimore, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe favorizimin e përparimit të kulturës, shkencës, trajnimit dhe kërkimit në vendet e zonës adriatiko-joniane.

## 6.7 Aktivitete të edukimit të vazhdim, të akredituara nga Qendra e Zhvillimit Profesional në UMT

Qendra e Zhvillimit Profesional është njësia që ka si qëllim parësor ofrimin e edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë të certifikuar. UMT ka krijuar një numër të madh modulesh të formimit të vazhduar në funksion të përditësimit të kualifikimit profesional të vazhdueshëm të tyre si dhe freskim dhe thellim të njohurive përkatëse, të cilat hartohen dhe organizohen në nivel fakulteti/departamenti/shërbimi. Këto module janë të organizuara në formën e konferencave/seminareve/leksioneve të hapura, ku të interesuarit marrin kreditet përkatëse, certifikohen nga UMT. UMT ka kaluar në mënyre të suksesshme auditet e bëra në QZHP, duke fituar si i vetmi institucion arsimor publik në vend, statusin e ofruesit të akredituar pa limit.

Aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituar nga QZHP për vitin akademik 2021-2022, paraqiten si më poshtë vijon:

<b>Nr.</b>	<b>Titulli i aktivitetit</b>	<b>Data e aktivitetit</b>
1	Inflamacioni dhe Roli i imunitetit	Tetor 2021
2	Hipertensioni dhe dislipidemia: shkaqet, diagnostikimi dhe terapia	Shtator-Tetor, 2021
3	Dislipidemite dhe kompleksiteti I trajtimit te tyre	29 Shtator 2021
4	Perditesim lidhur me vitaminen D	25 Tetor 2021
5	Njohja dhe trajtimi i disa patologjive mjekesore ne praktiken e perditshme	14 Tetor 2021
6	Njohja dhe trajtimi I semundjeve ne fushen psikiatrike dhe neurologjike	22 Tetor 2021
7	Hepatiti B dhe C	22-29 Tetor 2021
8	Imuniteti dhe semundjet infektive	10-25 Nentor 2021
9	Manaxhimi I urgjences kirurgjikale traumatike dhe jotraumitike, dhe jo vetem"	12-13 nentor 2021
10	Konferenca Kombetare e Endokrinologjise takimi Vjeshte 2021	30 tetor 2021
11	Spektrumi I preeklampsisë- çrregullimet hipertensive të shtatzanisë	10-11 dhjetor 2021
12	Standarte transfuzionale nga dhurimi në përdorim	15 dhjetor 2021
13	Konferenca e 3-të e Shkencave Teknike dhe Diagnostikuese, sfida dhe prespektiva	9-10 dhjetor 2021
14	Roli i biomarkuesve të profilit lipidik dhe korrelacioni për zhvillimin e sëmundjeve kardiovaskulare	12 shkurt 2022
15	Inovacioni në trajtimin dhe menaxhimin e ASCVD dhe dislipidemive	15 shkurt 2022
16	Njohja dhe trajtimi i disa sëmundjeve në fushën e alergologjisë dhe të	24-25 shkurt 2022
17	ORL	09-31 mars 2022
18	Kërkimi Operacional në Sistemin Shëndetësor	17, 23, 24, 28 mars 4, 5, 7, 11, 14, 18, 21, 25, 28 prill, 2, 5, 9, 12, 16, 19, 23 dhe 30 maj 2022
19	Hipertensioni dhe dislipidemitë në sëmundjen renale kronike	10 mars 2022
20	Efektet imunomodulare të laktoferrinës në pediatri	2 prill 2022
21	Sfidat e menaxhimit ASCVD dhe dislipidemive: të rejtat mbi trajtimin e tyre	24 mars 2022
22	Roli i Mjekësisë Laboratorike në menaxhimin e pandemisë të COVID-19	16 prill 2022
23	Akademia e Nefrologjisë- glomerulonefritet dhe dislipidemia	30-31 mars
24	Menaxhimi i alergjisë nga Farmacisti	28 prill 2022
25	Konferencë Shkencore	22 prill 2022

26	Diabeti dhe Zemra	20 prill 2022 dhe 27 maj 2022
27	Konferenca e 28 e Kirurgjisë Shqiptare	20-21 maj 2022
28	Parandalimi dhe kontrolli I ASCVD: një prioritet i sëmundjeve jo të transmetueshme (SJT)	29 prill 2022 26 maj 2022
29	Neurokirurgjia e së ardhmes	3 qershor 2022
30	Update të fundit në okulistikë	27-28 maj 2022
31	Anemia në sëmundjen renale kronike: rekomandimet terapeutike dhe sfidat e reja të trajtimit	2 qershor 2022
32	Roli i Mjekësisë Laboratorike në menaxhimin e sëmundjeve kardio-vaskulare	11 qershor 2022
33	Njohja dhe trajtimi I disa patologjive mjekësore dhe ndikimi I tyre në jetën e pacientëve	31 maj 2022
34	Konferenca Kombëtare endokrinologji dhe diabetologji, takimi I pranverës 2022	4-5 qershor 2022
35	Merr kohë për mirëqënien tënde mendore	7 qershor 2022
36	Të rejtat mbi trajtimin konservativ dhe kirurgjikal të sëmundjes së Parkinsonit	14 qershor 2022
37	Sfidat e shëndetit mendor në një realitet të ri	15 korrik 2022
39	Kongresi i 9-te i Mjekësisë Perinatale per Europen Juglindore dhe Kursi i 7-te i Avancuar i ekografise ne Obstetrike-Gjinekologji	29-30 shtator 2022, 1 tetor 2022
40	Nefropatia diabetike- e ardhmja është tani	5 tetor 2022
41	Njohja dhe trajtimi i sëmundjeve në fushën e neurologjisë dhe atë të otorinolaringologjisë	20 tetor 2022
42	Konferenca Kombëtare Vjetore e XVIII, Endokrinologji dhe Diabetologji	29 tetor 2022
43	Konferenca e 29- Kirurgjikale Shqiptare	28-29 tetor 2022

## VIII. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA NË FUNKSION TË AKTIVITETIT AKADEMIK

### 7.1 Infrastruktura, logjistika dhe shërbimet

Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, zhvillojnë aktivitetin akademik dhe procesin mësimor në godinat si më poshtë:

1. Godina Qendrore
2. Godina e Lëndëve Paraklinike
3. Godina e Anatomisë
4. Godina e Mjekut të Familjes
5. Godina Galileo Galilei
6. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik\*
7. Godina nr. 1 e Shkencave Mjekësore Teknike
8. Godina nr. 2 e Shkencave Mjekësore Teknike
9. Godina e Mjekësisë Dentare

Theksojmë faktin se vendndodhja e godinave në funksion të veprimtarisë akademike, kërkimore

e shkencore është në kampuse universitare spitalore (përveç Godinës Qendrore dhe Godinës së Farmacisë dhe Shëndetit Publik), lehtësisht të arritshme nga studentët nëpërmjet transportit publik për në spitalet universitare.

UMT-ja, referuar aseteve infrastrukturore në pronësi të saj, me një sipërfaqe rreth 17,000m<sup>2</sup> (nga të cilat 12,000m<sup>2</sup> në funksion të procesit mësimor dhe 5,000m<sup>2</sup> në funksion të veprimtarisë administrative), disponon auditorë, klasa, laboratorë, mjedise për personelin akademik, salla mbledhjeje, salla kompjuterësh etj., si më poshtë:

1. Godina Qendrore përfshin 2 auditorë, me kapacitet përkatësisht 60 dhe 100 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative.
2. Godina e Lëndëve Paraklinike përfshin 3 auditorë leksionesh, me kapacitet 250 vende uljeje, 21 salla seminari me 30 vende uljeje, 13 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 31 zyra administrative.
3. Godina e Anatomisë përfshin 2 auditorë, me kapacitet 210 vende uljeje, 2 salla seminari me 30 vende uljeje, 5 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 9 zyra administrative.
4. Godina e Mjekut të Familjes përfshin 1 auditor, me kapacitet 150 vende uljeje, 2 salla seminari me 20 vende uljeje, si dhe 2 zyra administrative.
5. Godina Galileo Galilei përfshin 1 auditor, me kapacitet 150 vende uljeje, si dhe 3 zyra administrative.
6. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik përfshin 1 auditor me kapacitet 100 vende uljeje, 5 salla seminari me 30 vende uljeje, 12 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 20 zyra administrative. *Kjo godinë pritet të jetë funksionale pasi pësoi dëme të konsiderueshme nga tërmeti i nëntorit 2019.\**
7. Godina nr. 1 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 6 auditorë, me kapacitet 330 vende uljeje, 10 salla seminari me 50 vende uljeje, 4 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative.
8. Godina nr. 2 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 11 auditorë me kapacitet 780 vende uljeje, 14 salla seminari me 50 vende uljeje, 3 laboratorë me 70 vende uljeje, si dhe 21 zyra administrative.
9. Godina e Mjekësisë Dentare përfshin 2 auditorë, me kapacitet 200 vende uljeje, 3 salla seminari me 60 vende uljeje, 15 laboratorë me 25 vende uljeje, si dhe 14 zyra administrative.
10. Palestra sportive (shkolla “Skënder Çaçi”) është në shërbim të studentëve dhe personelit.
11. Biblioteka/salla leximi, 4 ambiente, ku mundësohet edhe aksesimi në internet.

Në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor, investime të reja janë realizuar, si më poshtë:

- Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë ndërtuar 2 laboratorë modernë për infermieristikën, në partneritet me projektin HAP, në kuadër të hapjes së programit Master Profesional në “Infermieri familje”.
- Në Fakultetin e Mjekësisë është ndërtuar laborator i biosimulimit klinik, me mbështetjen e Global Found, i vetmi në llojin e vet në vend. Ky laborator ka luajtur një rol të rëndësishëm në trajnimin e personelit mjekësor gjatë pandemisë Covid 19.

Gjithashtu, në kuadër të Paktit për universitetin, është miratuar dhe pritet të fillojë zbatimi i projektit të Kampusit Multifunksional për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i cili do të mundësojë sigurimin me cilësi dhe në formë të përqendruar:

- të laboratorëve të biosimulimit teknik në funksion të procesit mësimdhënës për të gjitha programet e studimit që ofron UMT-ja,
- të qendrës së zhvillimit profesional
- infrastrukturën e nevojshme për testimin dhe vlerësimin e informatizuar si për studentët që regjistrohen për herë të parë, ashtu dhe për pranimet e specializantëve, testeve të pjeshme semestrale etj.
- të bibliotekës qendrore e UMT (sipas standardeve evropiane , ku përveç fondit të titujve të shërbeje dhe salle leximi),
- të sallës Aula Magna e Universitetit me kapacitete 300-350 vende ulje
- Zyra, kafeteri për studentet dhe tjerët, si dhe ambiente teknike shërbimit.

Pjesë integrale e UMT janë edhe qendrat spitalore universitare (rreth 130,000m<sup>2</sup>), si:

1. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë<sup>11</sup>.
2. Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"<sup>12</sup>
3. Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni"<sup>13</sup>
4. Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë<sup>14</sup>
5. Spitali Universitar i Traumës, Tiranë<sup>15</sup>
6. Klinika Stomatologjike Universitare<sup>16</sup>
7. Instituti i Shëndetit Publik<sup>17</sup>
8. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut<sup>18</sup>.

<sup>11</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/654>

<sup>12</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/655/1b7da247-846f-475d-b7fc-fdd260fca8d2;q=vkm%20655%20date%2010.11.2017>

<sup>13</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/656/f77737b8-6c45-45cb-b812-fec9256bed64;q=vkm%20656%20date%2010.11.2017>

<sup>14</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/658/266dfd4c-0945-46d1-a8a2-0a38b3017762;q=vkm%20658%20date%2010.11.2017>

<sup>15</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/11/10/657/fcd95b30-773f-4acf-947c-fd5bb8bb7ab3;q=vkm%20657%20date%2010.11.2017>

<sup>16</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/03/66/ebf58427-d7c1-4f3a-ae32-426ddb24d7e8;q=vkm%2066%20date%2003.02.2017>

<sup>17</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/03/66/ebf58427-d7c1-4f3a-ae32-426ddb24d7e8;q=vkm%2066%20date%2003.02.2017>

<sup>18</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/03/66/ebf58427-d7c1-4f3a-ae32-426ddb24d7e8;q=vkm%2066%20date%2003.02.2017>

## IX. STUDENTËT

### 8.1 Regjistrimet në programet e studimit për vitin akademik 2021-2022

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ofron programe studimi ndër më të kërkuarat nga maturantët. Përzgjedhja e studentëve të rinj në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë është bërë mbi bazën e kritereve të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga Senati Akademik i UMT-së.

Procesi i përzgjedhjes së studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruara të ciklit të dytë, kryhet dhe administrohet nga komisioni përkatës, i ngritur në nivel institucioni, me përfaqësues të fakulteteve dhe të rektoratit.


Procesin e përzgjedhjes së studentëve që aplikojnë në kuotat e veçanta apo transferim studimesh, në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, e kanë menaxhuar vetë njësitë kryesore, ndërsa Rektorati i UMT-së ka luajtur rolin e monitoruesit.

Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, në përputhje me kërkesat e njësive kryesore, Rektori i UMT-së ka miratuar rialokim të kuotave për programet e të njëjtit cikël studimi, duke mos tejkalluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore.

Senati i UMT-së, për vitin akademik 2021-2022, ka miratuar në total **2485** kuota, për regjistrimet e reja të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të integruara të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, në përputhje me standardet e përcaktuara për raportin personel akademik me kohë të plotë për studentë dhe normativën për sipërfaqen e shfrytëzueshme për student sipas kornizës ligjore në fuqi.

Kuota të miratuara me vendim të Senatit Akademik të UMT për vitin 2021-2022 janë si vijon:

	<b>Bsc.</b>	<b>MP.</b>	<b>Msc.</b>	<b>PICD</b>	<b>SPA</b>	<b>Totali</b>
Fakulteti i Mjekësisë	30	55	25	454	309	<b>873</b>
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	117			131	10	<b>258</b>
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	608	436	310			<b>1354</b>
<b>TOTALI</b>	<b>755</b>	<b>491</b>	<b>335</b>	<b>585</b>	<b>319</b>	<b>2485</b>



Nga të gjithë kuotat e miratuara, shkalla e realizimit të tyre ka qenë si më poshtë:

<i>Numri i kuotave të realizuara për vitin akademik 2021-2022</i>					
<b>Njësia kryesore</b>	<b>Bsc.</b>	<b>MP.</b>	<b>Msc.</b>	<b>PICD</b>	<b>SPA</b>
Fakulteti i Mjekësisë	20	45	43	387	206
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	105			104	7
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	522	169	193		
<b>TOTALI</b>	<b>647</b>	<b>169</b>	<b>236</b>	<b>493</b>	<b>213</b>

Shkalla relativisht e ulët e realizimit të kuotave të miratuara për programet e ciklit të dytë, veçanërisht në programet “Master Profesional”, është e shpjgueshme me faktin se një numër i konsiderueshëm studentësh që përfundojnë studimet e ciklit të parë, kryesisht në shkencat mjekësore teknike, zgjedhin të punësohen. Ky është një tregues se formimi që ata marrin në studimet e ciklit të parë Bachelor, i bën ata të aftë dhe konkurrues për tregun e punës, brenda dhe jashtë vendit.

UMT-ja, për vitin akademik 2021-2022, ka pasur në total, rreth **5226** studentë në programet e studimit të të gjitha cikleve. Numri total i programeve aktive që janë ofruar për të gjitha ciklet e studimit është **63** (9 Bachelor, 9 Master profesional, 7 Master i shkencave, 3 PICD, 35 SPA). Shpërndarja e studentëve sipas cikleve të studimit, paraqitet si në tabelën dhe grafikun më poshtë:

	Bsc	MP	Msc	PICD	SPA	Dr	Totali
Fakulteti i Mjekësisë	57	45	43	2390	750	221	<b>3506</b>
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	105			608	27	25	<b>765</b>
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	522	169	191			73	<b>955</b>
<b>TOTAL</b>							<b>5226</b>

Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të integruar të ciklit të dytë janë kryer bazuar në Udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin Nr. 10, datë 15.5.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.

Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të tretë (SPA) janë kryer duke u bazuar në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në UMT, Vendimit nr. 9, datë 04.02.2022 “Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjatë në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2021-2022, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të Senatit Akademik të UMT, si dhe në Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 1, datë 08.02.2022 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2021-2022”.

Periudha e pranimeve në programet e ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në sajë të procedurave të miratimit të kuotave për këto lloj programesh, përkon në muajin shkurt-mars të çdo viti.

## 8.2 Mbështetja ndaj studentëve

Në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UMT-së, si dhe legjislacionit në fuqi, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, mbështet studentët në nivel universiteti dhe kryesisht në nivel fakulteti. Kjo mbështetje i është dhënë si nga ana infrastrukturore dhe financiare, pjesëmarrje në projekte Erasmus, ashtu dhe nëpërmjet mbështetjes së pedagogëve lidhur me aktivitet shkencore, në konkurse etj.

### Aktivite në mbështetje të studentëve

Titulli i Aktivitetit	Data
Libri mjekësor flet shqip	9.06.2021
“Ceremonia e Bluzave të Bardha”	16.10.2021
Takim me studentët- Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian z. Luigi Soreca	17.11.2021
“Ceremonia e ndarjes së Medaljes së Artë për maturantët e vitit 2020-2021”	20.11.2021
Me zemër Organizuar nga Njësia e këshillimit të karrierës	22.12.2021
Pjesëmarrje e disa studentëve “Konferenca studentore ndërkombëtare” në Semmelweis University, Hungari	Shkurt 2022
Thirrje për audicione- “E dua Teatrin”	9.04.2022
Ceremonia e Diplomimit të Studentëve të viteve 2020-2021	04.07.2022

Përveç mbështetjes së studentëve nëpërmjet ofrimit të infrastrukturave bashkëkohore, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë zbaton rregullisht një politikë të mbështetjes financiare të studentëve, të kategorive të veçanta, si:

- Komuniteti Ballkano-Egjiptian
- Studentë me aftësi ndryshe;
- Studentë me prindër invalid, jetim, etj;

Një vëmendje të veçantë, UMT ia kushton studentëve me arritje të larta akademike, atyre me ndihme ekonomike apo me aftësi të kufizuara (cikli I dhe II) duke i mbështetur ata me bursa, përjashtim nga tarifa e shkollimit apo përgjysmim të saj.

Në total përfitojnë bursë rreth 45% <sup>19</sup>e studentëve të UMT (4130 ne total), nga të cilët:

- 80% për arritje akademike;
- 20% me ndihmë ekonomike;

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë që nga viti 2018 ka ngritur Shoqatën e Sportit të UMT me qëllim:

- promovimin e sportit, nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve sportive që do të realizohen me mbështetjen edhe të institucioneve të tjera vendore/lokale dhe qendrore.

<sup>19</sup> Informacion nga Drejtoria Ekonomike, Rektorat

- Të organizojë veprimtari sportive, në rang lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Të organizojë skuadra (ekipe) sportive në disiplina të ndryshme sportive;
- Të zhvillojë sportin universitar në të gjitha nivelet sportive;
- Të propagandojë/promovoje të gjitha rezultatet e arritura nga studentët në disiplina të ndryshme sportive;
- Organizimi i kampeve, seminareve, trajnimeve, publikimeve profesionale, etj., konform dispozitave ligjore, me qëllim avancimin e sportit.
- Nxitja e zhvillimit të sportit në rang universitetesh në nivel dhe sigurimi i pjesëmarrjes së shoqatës në gara dhe turne ndërkombëtare.

Gjithashtu pranë Rektoratit të UMT-së është kompletuar struktura me një specialist të sportit i cili bashkëpunon ngushtë me shoqatën sportive si dhe me strukturat e tjera të njësive kryesore për aktivizimin e studentëve të viteve të ndryshme në pjesëmarrje në aktivitete sportive të cilat organizohen në rang universiteti/lokal apo dhe nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar.

UMT mori pjesë në “*Turneun Universitar të Tiranës*” të organizuar nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar në disiplinat *Futsal*, *Basketboll* dhe *Volejbol* për meshkuj dhe femra.

Në muajin Shtator 2022, UMT ishte pjesë e organizimit të *Triathlon LABEAT*, garë në 3 disiplina, zhvilluar në Shirokë, Shkodër, me moton “*Vrapo për shëndetin*”, ku morën pjesë studentë dhe pedagogë të UMT-së.



Në muajin Dhjetor 2022 mori pjesë në kupën studentore dimërore të organizuar nga instituti “*Jeta e Re*” në bashkëpunim me “*Federatën Shqiptare të Sportit Universitar*”, ku ekipi i djemve të UMT-së në disiplinën e futbollit arritën deri në finale.



## 8.2 Performanca e alumni-t

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë mbledh periodikisht të dhënat për punësimin e alumni-t të tij, nëpërmjet të dhënave zyrtare nga Urdhrat përkatës për profesionet e rregulluara, Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), zyrat e karrierës në nivel Fakulteti, si dhe projekti GRADUA. Të dhënat bëhen pjesë e një relacioni të detajuar, në të cilin analizohen dhe krahasohen me trendin e viteve të kaluara. Gjatë 5 viteve të fundit, punësimi i *alumni-t* të UMT-së paraqitet sa më poshtë:

- Mesatarisht 86% e kandidatëve *alumni* UMT që janë nënshtruar provimit të licencës kanë fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit të tyre. Konkretisht, 92% e kandidatëve mjekë; 89% e kandidatëve farmacist; si dhe 77% e kandidatëve infermier, mami, fizioterapist, teknik laborator, teknik imazherie dhe logopedist.
- Në provimin për ushtrimin e profesionit, vlerësimi mesatar i kandidatëve fitues të diplomuar në UMT është 79/100 pikë. Në mjekësi vlerësimi mesatar është 83/100 pikë, në farmaci 81/100 pikë, në infermieri, mami, fizioterapist, teknik laborator, teknik imazherie dhe logopedist 71/100 pikë.
- Rreth 92% e të gjithë kandidatëve alumni UMT (mjekë, farmacistë, infermierirë, fizioterapistë etj.) që kanë marrë pjesë në provimin e praktikës profesionale kanë rezultuar fitues.
- Punësimi i të diplomuarve në UMT në Republikën e Shqipërisë për profesionet e rregulluara është mbi masën 95%.
- Gjatë viteve 2017-2021, janë pajisur me “*Certifikatën e Sjelljes së Mirë Profesionale*” nga Urdhrat përkatës të profesioneve të rregulluara rreth 1495 profesionistë të diplomuar në fushat e mjekësisë në UMT. Krahasimisht me numrin e anëtarëve të rinj në Urdhrat përkatës të profesioneve të rregulluara, u konstatua se rreth 28% e tyre pajisen me dokumentacion për punësim jashtë vendit.

## X. ANALIZA FINANCIARE 2022

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ushtron funksionet e tij akademike dhe administrative nëpërmjet Administratës së UMT-së dhe tre Njësive Kryesore (Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare).

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Shkencën në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimi në sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së UMT-së, po ju paraqesim relacionin mbi aktivitetin ekonomik- financiar.

Aktiviteti ekonomik dhe financiar bëhet në mbështetje të veprimtarisë themelore të institucionit që është edukimi i studentëve në tre ciklet e studimit konform standardeve më të larta profesionale, përgatitjen e gjithëanshme teorike-praktike të profesionistëve, arritjen e standardeve të larta në kujdesin shëndetësor si dhe stimulimin për të promovuar dhe çuar përpara kërkimin shkencor.

Për realizimin e këtij aktiviteti janë të domosdoshme Burimet Njerëzore dhe Financiare.

### A- Burimet njerëzore të UMT-së

Numri i punonjësve të planifikuar, të miratuar të UMT-së është 550 punonjës. Gjatë gjithë vitit akademik, organika ka qenë e paplotësuar dhe në fund të vitit akademik 2021- 2022, kemi në fakt 475 punonjës, pra 75 punonjës më pak, nga të cilët 41 punonjës staf akademik, 23 punonjës staf ndihmës akademik me karakter mësimor e administrativ dhe 11 punonjës staf administrativ.

Të dhënat në lidhje me numrin e punonjësve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Nr.	NJËSITË UMT	Nr. i personelit të UMT-së sipas kategorive									Total UMT			% e realizimit
		Personel staf akademik			Personel ndihmës akademik			Personel Administrativ			Plan	Fakt	Dif.	
		Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.				
1	Fakulteti i Mjekësisë	226	203	23	62	49	13	28	26	2	316	278	38	88%
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	82	66	16	29	27	2	19	14	5	130	107	23	82%
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	24	22	2	14	13	1	7	7	-	45	42	3	93%
4	Njësia kryesore UMT	0	0	0	33	26	7	26	22	4	59	48	11	81%
<b>TOTALI</b>		<b>332</b>	<b>291</b>	<b>41</b>	<b>138</b>	<b>115</b>	<b>23</b>	<b>80</b>	<b>69</b>	<b>11</b>	<b>550</b>	<b>475</b>	<b>75</b>	<b>86%</b>
	Pesha specifike e çdo njësie kundrejt totalit	60%	61%		25%	24%		15%	15%		100%	100%		

### Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor 1 vjeçar.

Hartimi i treguesve PBA 2022-2024 dhe rishikimet e treguesve gjatë hartimit të PBA 2023-2025 janë bërë në përputhje me kuadrin parashikues të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, plotësimin e rekomandimeve të Raportit të Akreditimit Institucional, si dhe në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuar për realizimin e politikave dhe misionit të UMT-së.

Hartimi i PBA-se është ndërtuar, bazuar në ecurinë e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitet 2022 dhe 2023, si dhe në ndryshimet e pritshme në programet e studimit, numrit të studentëve dhe në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit.

### Burimet e Financimit

Financimi i aktivitetit të UMT-së, sipas përcaktimeve të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë nr.80/2015, realizohet nëpërmjet tre rrugëve.

1. Granti i mësimdhënies i detajuar për pagat dhe sigurime shoqërore, shpenzime materiale dhe shërbime, bursat e studentëve. *(Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit)*
2. Të ardhurat e kushtëzuara të institucionit *(për funksionim dhe investime)*
3. Burime të tjera të ligjshme *(donacione, projekte).*

Burimet e financimit sipas PBA 2022-2024, të rishikuara gjatë hartimit të PBA 2023-2025 për grandin buxhetor dhe të ardhurat e veta paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMERTIMI	I pritshmi 2022	2023	2024	2025
		000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë
1	Granti i mesimdhënies I vitit dhe I trashëguar	911,990	889,572	889,572	889,572
2	Të ardhura të institucionit - Fonde të kushtëzuara	210,964	427,176	444,697	464,386
3	Fonde te trashge ta ardhura	802,514	498,910	543,539	614,092
	<b>TOTALI</b>	<b>1,936,582</b>	<b>1,815,657</b>	<b>1,877,808</b>	<b>1,968,050</b>

Burimet e financimit duke patur parasysh gjendjen reale financiare të UMT-së për grandin buxhetor dhe të ardhurat e veta paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMERTIMI	I pritshmi 2022	2023	2024	2025
		000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë
1	Granti i mesimdhënies I vitit dhe I trashëguar	926,628	889,572	889,572	889,572
2	Të ardhura të institucionit - Fonde të kushtëzuara	234,187	427,176	444,697	464,386
3	Fonde te trashge ta ardhura	802,514	498,910	543,539	614,092
	<b>TOTALI</b>	<b>1,974,444</b>	<b>1,815,657</b>	<b>1,877,808</b>	<b>1,968,050</b>

## Të ardhurat e institucionit

Në parashikimin e krijimit të të ardhurave është mbajtur parasysh realizimi i të ardhurave në vitet e kaluara, numri i programeve të studimit, numri i studentëve aktualë, kuotat e reja (shtesë) për vitin akademik 2021-2022, tarifatat aktuale të pagesës së shkollimit sipas viteve si dhe burime të tjera që janë të ardhurat nga tarifatat e regjistrimit etj.

Të ardhurat e tjera që ne siguronim nga vërtetimet, programet etj për vitet në vazhdim janë parashikuar në vlera minimale, për arsye se me Vendimin e përbashkët nr.72, datë 14.12.2018 “Mbi kërkesat e këshillave studentore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, këto tarifa janë hequr për studentët gjatë viteve të studimit.

Të ardhurat e parashikuara për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	NJËSITË SHPENZUESE	Të ardhura dytësore të pritshme me vlera te plote	Vlera që arkëtojnë fakultetet nga 50% i tarifës +cikli i dyte dhe i trete	Vlera që do të financohet nga buxheti i shtetit	Në 000/lekë	
					Nga këto	
					Vlera që financohet për pagesen 50% të tarifës	Studentë që përjashtohen nga tarifa fonde që do të përballohen nga buxheti i shtetit
1	Fakulteti i Mjekësisë	206,405	136,384	70,021	35,255	34,766
2	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	103,392	56,999	46,394	16,720	29,674
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	37,111	16,081	21,030	10,435	10,595
4	Njësia qendrore UMT-së	1,500	1,500	-	-	-
	<b>TOTAL</b>	<b>348,408</b>	<b>210,964</b>	<b>137,445</b>	<b>62,410</b>	<b>75,035</b>

Për vitet në vazhdim nuk është parashikuar asnjë rritje e tarifave të shkollimit, dhe të gjitha parashikimet janë bërë me tarifatat aktuale, pavarësisht se kostoja aktuale për të gjitha ciklet e studimit në vitet e mëparshme është më e lartë se tarifa që paguhet nga studentët dhe financohet nga buxheti i shtetit. Të ardhurat e planifikuara për vitet në vazhdim janë llogaritur me tarifa të plota sipas formatit të PBA-së

Parashikimi i të ardhurave të pritshme sipas burimeve të krijimit sipas PBA-së 2023-2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
		000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë
1	Qeratë			
2	Tarifë shkollimi	225,328	241,200	256,570
3	Master profesional	33,192	33,192	33,192
4	Master Shkencor	36,540	38,535	39,060
5	Specializime+doktoratura	118,435	118,990	121,885
6	Tarifë rregjistrimi	6,722	6,721	6,721
7	Të Tjera	6,959	6,959	6,959
	<b>Total te ardhura</b>	<b>427,176</b>	<b>445,597</b>	<b>464,387</b>

## Parashikimi i shpenzimeve sipas PBA-së

Në parashikimin e shpenzimeve të PBA-së 2022-2024, të rishikuara gjatë hartimit të PBA 2023-2025 është mbajtur parasysh parashikimi i nevojave për paga sigurime shoqërore për stafin akademik dhe stafin mbështetës, plotësimi sa më i mirë nevojave me bazë materiale dhe sigurimi i zhvillimit normal të aktivitetit të UMT-së.

Në përcaktimin e shpenzimeve sidomos materiale, shërbime dhe investimeve parashikimi është shoqëruar me një proces të mbledhjes së kërkesave nga të gjithë departamentet, shërbimet dhe njësitë.

Në këtë program buxhetor afatmesëm, financimi i shpenzimeve të projekteve për investimeve është parashikuar të kryhen nga të ardhurat që krijojnë njësitë shpenzuese të UMT-së.

Nr.	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
		000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë
1	Paga art. (600)	746,632	746,632	746,632
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	107,115	107,115	107,115
3	Shpenzime operative art. (602)	172,102	175,543	176,896
4	Shpenzime transferta te brendshme art. (604)	200	200	200
5	Shpenzime transferta me jashte art. (605)	473	470	470
6	Bursa per studentet art. (606)	163,780	164,680	164,860
7	Investime nga te ardhurat art. 230+231	239,489	137,551	62,673
	<b>Total</b>	<b>1,429,791</b>	<b>1,332,191</b>	<b>1,258,846</b>

Është parashikuar kërkesë për fonde nga buxhetit i shtetit për rindërtimin e godinave të dëmtuara nga tërmeti. Vlera përfundimtare e projekt-preventivit për ndërtim është 353,528,249 lekë, për rindërtimin e godinave si më poshtë:

1. Godina e Anatomisë – 91,569,144 lekë
2. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik – 225,248,193 lekë
3. Godina e Leksioneve te Godina e Paraklinikut– 36,710,912 lekë

Sa më sipër, është parashikuar që Godina e Anatomisë dhe Godina e Leksioneve te Godina e Paraklinikut, në vlerë totale 128,280,056 lekë, të rindërtohen nga të ardhurat e UMT-së, ndërsa për Godinën e Farmacisë dhe Shëndetit Publik në vlerën 225,248,193 lekë, do të kërkohet rindërtimi nga fondet grant të buxhetit të shtetit.

## **B- Analiza e treguesve ekonomik - financiarë**

Hartimi i buxhetit të vitit 2022, është bazuar në projektet e paraqitura në periudhën e hartimit të programit afatmesëm 2022-2024, në ndryshimet e ndodhura pas miratimit të tij, në strukturën organizative, programet e studimit, numrit të studentëve, realizimin e buxhetit të vitit 2021, si dhe në nivelin e financimit të pritshëm nga Buxheti i Shtetit.

Pas miratimit të shpërndarjes së grantit të mësimdhënies akorduar nga buxheti i shtetit në fillim viti 2022 për UMT-në si dhe bazuar në fondin grant të trashëguar, njësitë shpenzuese të UMT-së,

përgatiten treguesit e rishikuar të buxhetit 2022 dhe pasi u miratuan në strukturat e tyre, me Vendim nr.33, datë 13.04.2022 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2022, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” u miratua dhe nga Bordi i Administrimit. Gjithashtu, në zbatim të VKM-ve të dala gjatë vitit 2022 si dhe nevojave të institucionit u rishikuan treguesit e buxhetit për vitin 2022 dhe u bë rishpërndarja e tyre pas miratimit në organet kolegjale të UMT-së.

Në mënyrë të përmbledhur treguesit financiarë të vitit 2022 janë si më poshtë:

Fonde **në dispozicion** të UMT-së (grandi i mësimdhënies + të ardhurat) sipas të dhënave financiare janë 1,993,722 mijë lekë, kodi thesarit 9450.

Fondet e **parashikuara për përdorim** (grandi i mësimdhënies + të ardhurat) të miratuara me VBA janë 1,477,380 mijë lekë, kodi i thesarit 9450.

Fondet e **përdorura** gjatë vitit 2022, (grandi i mësimdhënies + të ardhurat) kodi i thesarit 9450, janë 977,705 mijë lekë ose **66.2%**.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet buxheti i rishikuar i vitit 2022 për UMT-në, miratuar me vendime të Bordit të Administrimit krahasuar me PBA 2022.

Institucioni	Emërtimi i shpenzimeve	Llogaria buxhetore	Viti 2022 në /lekë	
			Kërkesa në PBA	Buxheti i rishikuar viti 2022 (Buxheti v.2022)
UMT	Paga dhe shperblime	600	753,230	560,289
UMT	Paga dhe shperblime	600	-	236,972
UMT	Sig.Shoqe dhe shend	601	107,065	85,867
UMT	Sig.Shoqe dhe shend	601	-	21,204
UMT	Mallra materiale	602	14,620	112,243
UMT	Mallra materiale	602	147,752	65,660
UMT	Transfer brendshme	604	478	30,672
UMT	Transfer te individet	606	500	8,580
UMT	Transfer te individet	606	150,692	161,605
UMT	Investime	231	78,686	185,787
<b>TOTAL UMT</b>			<b>1,253,023</b>	<b>1,468,878</b>
UMT	Projekte org.nderk thesa	602	-	8,502
<b>TOTAL UMT</b>			<b>1,253,023</b>	<b>1,477,380</b>
UMT	Projekte AKKSHI /602	602	-	15,498
UMT	Projekte AKKSHI /231	231	338	1,213
<b>Shuma projekte AKKSHI</b>			<b>338</b>	<b>16,710</b>
<b>TOTAL UMT</b>			<b>1,253,362</b>	<b>1,494,090</b>

Në vitin 2022 me VKM pati rritje të pagave si nga granti ashtu dhe nga të ardhurat.

Po ashtu edhe në zërin e investimeve të cilat gjatë vitit 2021 pothuajse nuk ishin realizuar dhe u parashikuan shtesë në buxhetin e rishikuar të vitit 2022.

## 1. Granti i vitit 2022

Për vitin 2022, granti i mësimdhënies me burim financimi buxhetin e shtetit, i akorduar gjatë vitit është në vlerën 926,628 mijë lekë. Ky grant iu shpërnda njërive shpenzuese të UMT-së në zbatim të VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 *“Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”* dhe Udhëzimit të përbashkët nr.20, datë 20.09.2019 *“Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”* të Ministrit të MFE-së dhe Ministrit të MASR-së.

Në shumën e grantit të mësimdhënies akorduar për UMT –në, përfshihet edhe kompesimi i 50% të tarifave të shkollimit për ciklin e parë dhe të integruar në zbatim të VKM nr. 778, datë 26.12.2018, kompesimi për tarifën e shkollimit për studentët e ekselencës në zbatim të VKM nr.779, datë 26.12.2018 dhe si dhe vlera e tarifave për studentët e ekselencës të ciklit të parë dhe të integruar në zbatim të VKM nr.779, datë 26.12.2018 dhe VKM-së nr 780, datë 26.12.2018 për studentët e ciklit të dytë si dhe studentët në nevojë.

Totali i fondeve grant buxhetor për vitin 2022 për mësimdhënien është 926,628 mijë lekë.

Ky fond përfshin grantin e akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 në vlerën 798,547 mijë lekë si dhe fondin e trashëguar nga viti i kaluar në vlerën 128,081 mijë lekë. Shpërndarja e këtyre fondeve është miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit nr.2, datë 18.01.2022 *“Për miratimin e shpërndarjes së grantit të mësimdhënies, për UMT, për vitin 2022”* me Vendimin Qarkullues të Bordit të Administrimit nr.61, datë 08.11.2022 *“Për miratimin e shpërndarjes së fondeve buxhetore të grantit të mësimdhënies, shtesë në buxhetin e vitit 2022 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”* si dhe Vendimin Qarkullues të Bordit të Administrimit nr. 01 datë 09.01.2023 *“Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore të grantit të mësimdhënies, për vitin 2022 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”* në kuadër zbatimit të VKM-së nr.898, datë 29.12.2022 *“Për mbështetjen financiare të menjëhershme të punonjësve të njërive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”*.

Detajimi i grantit të mësimdhënies i akorduar nga MAS, gjatë vitit 2022 si dhe grandit të trashëguar sipas njësive shpenzuese sipas dhe llogarive buxhetore paraqitet në tabelat e mëposhtme.

në 000/lekë

	NJËSITË	600 (paga)	601 (sigurime shoqerore & shëndet)	602 (mallra dhe shërbime)	606 (F.Veçantë)	TOTAL	606 (Bursa)	Total
1	Rektorati	52,191	8,746	15,202	12	76,152		76,152
2	Fakulteti i Mjekësisë	345,315	46,713	59,367	455	451,849	68,335	520,184
3	FSHMT	121,354	21,646	28,532	26	171,558	56,100	227,658
4	FMD	59,713	8,762	9,142	17	77,635	25,000	102,635
